



KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e VIII-të (tetë) -e rregullt, mandati VIII-të, e mbajtur më 23 prill 2026.

Mbledhja filloi në orën 10:15 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Isak Shabani Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV: *Adelinë Stublla; Artrit Mulliqi; Fatri Zhitija; Kasib Bashota; Florent Hasani; Valdet Kamerolli; Arbrim Konushevc; Flandra Kadriu; Luljeta Muçolli-Azemi; Vlora Jashanica; Haki Rudari; Avni Islami; Qëndresë Hajrizi; Ardi Hasani*, kurse mungoi *Abedin Zeka*.

Nga LDK: *Alisa Jetullahu; Enis Dervisholli; Besim Latifi; Valdet Restelica; Blerta Azemi-Berisha; Valon Demolli; Ekrem Rrahmani; Ermal Osmani; Gresa Qosa-Maqastena; Arben Xhemajli; Arnisa Sylejmani; Isak Ejupi*, kurse mungoi *Enis Shabani*.

Nga PDK: *Isak Shabani-Kryesues i Kuvendit; Lulzim Pollomi; Mimoza Abdullahu; Rinesa Goxhufi*,

Nga GUXO: *Demokrat Hodolli*, i cili mungoi.

Nga Unioni i Blakçorve: *Gentrit Arifi*.

Nga AAK: *Baki Feta*,

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, z.Fahri Restelica Nënkrjetar i Komunës; U.D. drejtorët/shat e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Ditjona Statovci-Drejtoria e Administratës DA; Arbnorë Uka Osmani-Drejtoria e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtoria e Arsimit DKA; Lirie Hoti Rama-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Ahmet Ahmeti-Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit; Saranda Stublla-Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Valbona Ibishi Azemi-Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Shuajb Blakçori-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Behram Latifi-Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE).

Të pranishëm ishin edhe, përfaqësues media lokale (TV Llapi), përfaqësues të KFOR; dhe disa zyrtar komunal.

Rendi i Ditës

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar punë të mbarë, konstatoi kuorumin ku për momentin sipas listës së nënshkrimeve dhe numërimit, 32 anëtar/e të Kuvendit ishin prezent për momentin në sallë, andaj mund të vazhdohet me punë, theksoi, njëherit ju njoftoj se z.Demokrat Hodolli ka lajmëruar mungesën për sot për arsye shëndetësore e që besoj se është vetëm një grip sezonal dhe i dëshiroj shërim sa më të shpejtë.

Kjo seancë është thirrur në përputhje me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës dhe në pajtim me Rregulloren e punës, andaj meqë ftesa dhe materialet për këtë mbledhje ju janë shpërndarë me kohë, unë e shpallë këtë mbledhje të VIII-të të mandatit të VIII-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Para vetës keni rendin e propozuar të ditës për këtë mbledhje i cili përfshinë edhe konstatimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa ku është përfshirë edhe një pikë shtesë për rendin e ditës (si pikë e pestë) që është Drafti i Programit Trevjeçar të Banimit 2026-2028 i propozuar nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, propozim ky i cili në mbledhjen e KPF-së është miratuar njëzëri për çka shprehë falënderimin tim për mirëkuptimin e treguar nga anëtarët e KPF. Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit lexon pikat e rendi të ditës, dhe njëkohësisht fton të marrë fjalën nëse ndokush dëshiron rreth rendit të ditës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ndoshta do të ishte mirë që drejtoresha përkatëse të arsyetoj sikurse që e bëri një ditë më parë në mbledhjen e KPF-së, fjala është për pikën shtesë që është shtuar në KPF dhe që është rekomanduar për këtë mbledhje të Kuvendit.

znj.Lirie Hoti-Rama, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, theksoi, dje në mbledhjen e KPF-së nga DSHMS është propozuar të shtohet si pikë e rendit të ditës Draft Programi Trevjeçar i Banimit në Komunën e Podujevës për vitet 2026 - 2027 - 2028. Kjo për shkaqe personale shëndetësore që kam pasë, nuk ka mundur të dërgoj me kohë materialet e kësaj pike, mirëpo ky draft Program ka qenë i publikuar edhe në ueb faqen e Komunës dhe gjithashtu i ka kaluar të gjitha procedurat për vënie në diskutim publik, dhe tani është pranë juve në Kuvendin e Komunës, kështu që kërkoj nga ana juaj në mirëkuptim që të përkrahet kjo pikë për përfshirje si pikë shtesë në këtë rend të ditës në këtë mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim rendin e ditës duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së të mbajtur më 22.04.2026.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 32 vota Për, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe duke përfshirë edhe pikën shtesë të rekomanduar nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa më 22.04.2026.

Rendi i miratuar i ditës:

- 1.Propozim Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026*
- 2.Raporti financiar për periudhën janar - mars 2026*
- 3.Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - Projekti “Furnizim me Mëshqerra”*
- 4.Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - Projekti “Furnizimi dhe Montimi i Serrave”*
- 5.Propozim Programi Trevjeçar i Banimit 2026-2028 në Komunën e Podujevës*
- 6.Të ndryshme*

1. Propozim Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, siç jeni në dijeni Grupi punues ka përgatitur një Draft të planit të punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2026. Po ashtu për këtë draft kemi mbajtur edhe një konsultim publik dhe pas atij konsultimi Grupi punues ka hartuar draftin final të këtij Plani të cilin e keni pranuar së bashku me materialet tjera të kësaj mbledhje, prandaj e hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

znj.Vlora Humolli-Jashanica, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e mbështesim Draft Planin e punës së Kuvendit për vitin 2026 dhe presim përkrahje nga të gjithë.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, si anëtare e Komisioni për hartimin e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2026 nga radhët e LDK-së, vlerësoj se Plani i punës së Kuvendit është një dokument

thelbësor për mbarëvajtjen dhe organizimin e punës së Kuvendit të Komunë, por megjithatë konsideroj se ky plan duhet të mbetet i hapur për propozime tjera nga ana e anëtarëve të Kuvendit në mënyrë që të pasurohet dhe përmirësohet përmes plotësim ndryshimeve të nevojshme.

Gjithashtu mendoj se nuk duhet të miratohet një plan pune që nuk ka vullnet dhe mekanizma të qartë për zbatimin e tij sepse kemi qenë dëshmtarë nga praktikata e kaluara ku edhe pse çështje të caktuara kanë qenë në plan të punës, siç janë shembull Informatat nga Drejtoritë e që nuk janë sjellë në Kuvend që i bie se drejtorët e Drejtorive nuk kanë raportuar sipas obligimeve të tyre, andaj për këtë arsye konsideroj se ajo praktikë e gabuar duhet të ndërpritet dhe të sigurohet zbatim real dhe i rregullt i planit të punës, e që me anë të kësaj nëse zbatohet ashtu siç po them unë do ta rrisim përgjegjësinë institucionale dhe transparencën ndaj Kuvendit dhe qytetarëve.

znj.Mimoza Abdullahu, theksoi, në emër të Grupit të PDK-së e përkrahim Draftin e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2026.

z.Besim Latifi, theksoi, fillimisht dua të theksoj disa nga vërejtjet të cilat do t'i paraqes të cilat janë më shumë rekomandime ose propozime sesa vërejtje, kjo me qëllim që të jap kontributin tim si anëtar i Kuvendit bazuar në kompetencat që kam dhe në përgjegjësinë që kemi ndaj qytetarëve që na kanë votuar. Gjithashtu konsideroj se një Plan i punës pas miratimit duhet të zbatohet në tërësi dhe për përgjegjës direkt jeni ju i nderuar Kryesues i Kuvendit, pra kjo është shumë më e rëndësishme se sa Plani i punës që nuk duhet të mbetet vetëm një dokument formal, por një udhërrëfyes real për funksionimin e Kuvendit gjatë gjithë vitit.

Duke u bazuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës së Podujevës, Rregulloren e Punës së Kuvendit, roli i Kuvendit është mbikëqyrja e Ekzekutivit, shqyrtimi i politikave komunale dhe përfaqësimi i interesit qytetarë. Po ashtu ne si këshilltarë të Kuvendit e kemi obligim të japim kontributin tonë aktiv në këtë drejti, andaj në këtë kontekst vlerësoj se Plani i propozuar më shumë ngjan me një agjendë të seancave gjatë një periudhe sesa një Plan i mirëfilltë i punës së Kuvendit komunal. Për këtë arsye konsideroj se duhet të përmirësohet në disa aspekte konkrete. Po filloj me buxhetin e Kuvendit komunal, pra Komuna jonë është një Komunë që ka mbi 70000 banorë dhe ka një buxhet total prej mbi 34 milion euro, ndërsa organi më i lartë i saj e ka një buxhet jashtëzakonisht të varfër të cilin e kemi diskutuar edhe dje në mbledhjen e KPF-së, kjo nuk duhet të pranohet, Kuvendi duhet të ketë një buxhet meritator për të ushtruar si duhet funksionin e tij. Pastaj propozimi i dytë është organizimi i seancave për tema kyçe, seancat ku trajtohen tema të rëndësishme së veçantë siç është raportimi financiar, buxheti i Komunës, raporti i auditorit, e që duhet të planifikohen pa u ngarkuar me shumë pika të tjera të rendit të ditës siç ka ndodhur në seancat e kaluara, në të kundërtën po humbet fokusi pastaj në këto çështje dhe nuk po trajtohen me seriozitetin e merituar. Kuvendi duhet të ketë më shumë hapësirë për debat, analizë dhe kontribut, sidomos për çështje që prekin drejtpërdrejtë interesin qytetar. Pra ky është funksioni ynë dhe duhet reflektuar qartë në planin tonë të punës.

Pastaj nën 3, është planifikimi i seancave solemne ose mungesa e tij, pra në këtë draft të këtij Plani mungon planifikimi i seancave solemne për data të rëndësishme siç është 17 Shkurti-Dita e Pavarësisë; 5 Marsi-Epopeja e UÇK-së; dhe 19 Qershori-Dita e Çlirimit të Podujevës. Pra këto seanca janë shumë të rëndësishme sepse në ato kujtojmë se kush jemi dhe cila është historia jonë. Këto seanca kërkojnë unitet institucional dhe përfaqësojnë respekt ndaj historisë dhe arritjeve tona, prandaj konsideroj se është e arsyeshme dhe e domosdoshme që këto seanca të planifikohen në kuadër të Planit vjetor të punës së Kuvendit. Pra ne Grupi i LDK-së kemi vërejtje për mënyrën se si janë organizuar dhe mbajtur këto seanca dhe i kemi adresuar zyrtarisht te Kryesuesi i Kuvendit për shkak të përjashtimit nga e drejta jonë e fjalës e që besoj se ju duhet të shikoni edhe praktikata e Komunave të tjera për të parë se si organizojnë këto seanca e në këtë drejtim mund të merret

shembull edhe Komuna e Fushë Kosovës, pra ku këto mbledhje solemne organizohen në mënyrë institucionale në ambiente më të mëdha e jo në sallën e Kuvendit, për tu dhënë mundësi të marrin pjesë dhe me një rend të qartë të fjalimeve sipas protokollit duke filluar nga Kryesuesi i Kuvendit, shefat e Grupeve e pastaj Kryetari i Komunës dhe mysafirët sipas planifikimi, prandaj e them se ky është rendi i Kuvendit.

Për fund, edhe njëherë e theksoj se këto janë rekomandime, propozime me qëllim të përmirësimit të Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2026 dhe të forcimit të rolit të Kuvendit të Komunës në mënyrë që të ushtrojmë sa më mirë funksionin tonë mbikëqyrës dhe përfaqësimit qytetarëve.

z.Haki Rudari, theksoi, Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës dhe në tërësi të Kuvendeve të Komunave në Kosovë është një dokument i rëndësishëm i cili lehtëson dhe ndihmon punime e mbledhjeve të Kuvendit. Plani i punës është i obligueshëm nga aspekti ligjor, Statuti, i Komunës dhe Rregullorja e punës, e them këtë për arsye se në të gjitha këto parashihet që të organizohen punëtori apo mbledhje të ndryshme me përfaqësues të partive politike, në këtë drejtim në këtë Kuvend është votuar një Komision. Përkundër kësaj ne kemi marrë pjesë në ato mbledhje që e përmendi Kryesuesi nëse nuk gaboj ka qenë data 5 mars ku kemi qenë në punëtori në Restorant Ora. Ky dokument është i rëndësishëm jo vetëm në aspektin formal por është i rëndësishëm nga brendia e dokumentit.

Te Rregullorja e punës së Kuvendit, neni 87 paragrafët 1 dhe 2, ndër të tjera po e citoj, në programin e punës përcaktohen punët dhe angazhimet e Kuvendit, aktivitetet dhe çështjet e parapara për shqyrtim, bartësit e përgatitjes së materialeve për shqyrtim dhe afatet e shqyrtimit të tyre, këtë nuk po e them unë sipas dëshirës por po e thotë Rregullorja që është votuar në Kuvend, pastaj paragrafi 87.3, programi i punës së Kuvendit miratohet mbi bazën e propozimeve të programit të Kryetarit të Komunës, Ekzekutivit, asambleistëve, Grupeve të asambleistëve, OJQ-ve dhe subjekte të tjera, pra në këtë kontekst unë konsideroj dhe vazhdimisht kam konsideruar edhe në Opozitë kur kemi qenë se është një dokument shumë i rëndësishëm.

Nuk mjafton vetëm miratim i i Planit të punës së Kuvendit, te neni 88 paragrafi 1, thuhet, pas miratimit të planit të punës, Kuvendi e përcakton, e që mendoj se është shumë më e rëndësishme, pra e përcakton kalendarin e mbajtjes së mbledhjeve dhe ky ndryshim i kalendarit të mbledhjeve mund të ndryshoj sipas Rregullores 7 ditë pune, prandaj vetëm kështu del një dokument i rëndësishëm, serioz dhe në kuptimin fuqiplotë për të gjitha partitë politike.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, plani i punës së Kuvendit edhe pse është i vonuar sepse ne jemi në dijeni që tani gati veç shkuan gjysma e mbledhjeve, unë edhe dje në KPF e potencova përse nuk janë publikuar listat/pronat që ne i kemi votuar dhe që janë paraparë të mbahen në muajt mars, maj, qershor, pra nuk janë përfshirë në këtë Plan të punës asnjë prej tyre. Shikova 2-3 prona të cilat janë votuar siç është shembull disa prona në fshatrat Revuçë, Bellosicë, pastaj Lokalet te Stadiumi i KF Llapi, të cilat janë paraparë në muajt mars-qershor kurse në këtë plan të punës nuk figurojnë askund, andaj nuk e di a duhet që ne t'i përfshijmë tani në Plan të punës meqë janë në Listën e veçantë e cila është votuar dhe që ato pika do të sjellën, por që ne ta dim dhe t'i shtojmë në këtë Plan të punës në mënyrë që ta dimë se në cilin muaj do të sjellën këto tema.

Sa i përket asaj që parafolësi z.Haki Rudari e përmendi orarin e mbledhjeve, nuk e di a ishte propozim e që edhe unë e përkrahi që të kemi një kalendarë apo orar se kur do të mbahen mbledhjet e Kuvendit, madje ndoshta do të ishte mirë të mbahen ose të hënave ose të premtëve sepse diqysh në mes javë ne që punojmë edhe privat ndoshta na bie më mirë t'i lëmë seancat të premtëve sepse qysh e përmenda në mes javë ne po duhet të shkojmë shembull të hënën nëpër puna, të marteve mbledhje pastaj sërish të mërkurën në punë, po na bie pak si pështjelltë, nëse ka mundësi të ndryshohet ditët e seancave.

z.Haki Rudari, theksoi, nuk dua të replikoj por dua të them që është problem ndoshta të caktohet një ditë e javës, të jetë vetëm e hëna ose vetëm premtja, por unë vetëm e potencova që parashihet kalendari i, shembull po supozoj tani për muajin janar ose për muajin maj mund të jepet një datë, shembull 10 maj, dhe kjo datë mund të ndryshoj 7 ditë pune, mund të kaloj deri më 17 maj ose datë tjetër brenda 7 ditëve të punës që nuk shkelet Rregullorja, pra kjo do të ishte e lehtë, mirëpo të caktohet dita e mbledhjes ndoshta është paksa më problem dhe më shumë ka vështirësi.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, vetëm deshta t’jua rikujtoj se ju keni qenë pjesë e Grupit punues për hartimin e këtij Plani të punës, nga të gjithë përfaqësuesit që janë këtu pjesë e Kuvendit të Komunës. E di që Plani i punës nuk është statik dhe nuk është i pandryshueshëm por ky është plani bazë. Po ashtu edhe lidhur me planifikimet e mbledhjeve solemne ne veç i kemi paraparë ato dhe i kemi futur në rend të ditës e që disa janë realizuar në muajt e kaluar, kështu që për 19 Qershor-Dita e Pavarësisë do të shqyrtohet mundësia, që vie propozimi a do të mbahet mbledhje solemne apo ndonjë akademi, mirëpo si do që të jetë dëshiroj të ndërlihem edhe me listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë këtij viti, edhe në Planin e punës është paraparë që përveç këtyre Kuvendi i Komunës kryen edhe aktivitete tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësive të saj përfshirë edhe funksione tjera, detyrat dhe përgjegjësitë e pa deleguara siç janë vendimet që kanë të bëjnë me pronën e Komunës, pra kjo është në këtë draft të planit të punës dhe atë në narrativë, në faqen 3, prandaj duke ditë këtë se Lista e veçantë është miratuar dhe është bërë një planifikim për datën e publikimit të njoftimit, mirëpo këto dërgohen në MAPL dhe për faktin që ende nuk janë kthyer është e pamundshme, prandaj edhe unë i bashkëngjitem kolegut z.Haki Rudari sa i përket mos caktimit të datës sakt për arsye se duhet shikuar mundësitë e përgatitjes së materialeve për seanca, mirëpo normale që kemi një pikë orientuese ashtu si do të vazhdojmë tutje.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, i dëgjova me vëmendje parafolësit por e kam shikuar edhe këtë draft të Planit të punës së Kuvendit për vitin 2026. Mendoj që edhe propozimet që dolën nga diskutimet e asambleistëve këtu besoj që janë të qëlluara. Mirë është që planifikimi i seancave solemne nuk është diçka që nuk dihet dhe mund të përfshihet brendapërbrenda Planit të Punës së Kuvendit, duhet të definohet. Pastaj u shtrua çështja e një salle më të madhe, mirëpo ne aktualisht i kemi këto tri mundësi për mbajtjen e seancave solemne, në ambientet e Galerisë së Qytetit e cila po ashtu nuk ka kushte kush e di sa më të mira, ose eventualisht mund të mbajmë në sallën e Teatrit të Qytetit nëse veç vlerësojmë dhe këtu në këtë sallë. Pra sigurisht se seancat solemne janë publike, nuk janë sekrete.

Sa i përket asaj që u the për tema të ndjeshme, unë mendoj se realisht të gjitha temat që trajtohen këtu në Kuvend besoj se janë të ndjeshme dhe kanë rëndësinë e vet.

Sa i përket orarit të takimeve apo mbledhjeve, zakonisht është punuar në atë mënyrë që mbledhjet të mbahen në javët e fundit të muajit që përfaqësojnë të ndërlihen seancat e Kuvendit, kurse për caktimin e ditëve mendoj se ndoshta më mirë gjithmonë është të veprohet ashtu qysh është praktikuar edhe më parë, dita e enjte ose e premte si ditë të fundjavës sepse fillim java nuk bash e qëllueshme për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit.

Si do qoftë këto mbledhje në shumicën e rasteve po koordinohen brenda juve, Kryesuesit të Kuvendit dhe udhëheqësve të Grupeve të anëtarëve të Kuvendit, mirëpo nganjëherë ka mbledhje të cilat po paraqitet nevoja të mbahen për ngutë por që ato mund të kalojnë edhe në pjesën e mbledhjeve të jashtëzakonshme që mund të thirren në një afat më të shkurtër kohor.

Besoj që në këtë aspekt nuk ka ndonjë telashe, janë punë të cilat mund të zgjidhen me kompromise dhen diskutime mes Grupeve parlamentare të këtij Kuvendi dhe Kryesuesit të Kuvendit.

Përndryshe mirë është që është një Plan i punës së Kuvendit dhe do të bëjmë përpjekje si Ekzekutiv i Komunës për t'i respektuar ato periudha kohore, qoftë të informatave qoftë të raportimeve të cilat janë të nevojshme të bëhen në Kuvend dhe besoj që do të bëjmë maksimumin t'iu përgjigjemi këtyre periudhave kohore, kështu që unë sërish e them se besoj që është një dokument relativisht mirë i kompletuar, me këto plotësime që mund të bëhen duke u inkorporuar, finalizuar dhe të shkohet përpara.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë nëse nuk gaboj, për mbledhje solemne mund t'i hedhim në votim që të përfshihen në Plan të punës, 19 Qershori për të cilën besoj kemi unifikim të plotë, pastaj kemi 5 Majin-Ditën e Dëshmorëve dhe të Rënëve, 28 nëntorin, dhe mbledhjet tjera të mbajtura, atëherë me këto vërejtje, sugjerime dhe propozime që ishin dhe që u potencuan edhe nga Kryetari i Komunës që të inkorporohen në Plan të Punës, e hedh në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 32 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë miratohet Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026 sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe propozimet shtesë në këtë mbledhje dhe atë që në kuadër të Planit të përfshihen edhe mbledhjet solemne, përkujtime dhe manifestimet të cilat vazhdimisht mbahen për çdo vit në datat dhe ditët përkatëse.

2. Raporti financiar për periudhën janar - mars 2026

znj.Arbnorë Uka-Osmeni, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financa-DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij Raporti, ndër të tjera theksoi, para jush kemi prezantuar raportin për kuartalin e parë janar-mars për vitin fiskal 2026i cili pasqyron aktivitetet financiare që janë kryer gjatë kësaj periudhe. Qëllimi i këtij Raporti është të prezantohet një pasqyrë e aktiviteteve financiare të zhvilluara gjatë tremujorit të vitit 2026. Siç e dim buxheti për vitin 2026 është i aprovuar në Kuvendin e Komunës në vlerë të përgjithshme 34,778,954.00€, ndërsa te performanca e shpenzimeve apo progresi i shpenzimeve për këtë periudhë kemi vlerën totale 9,287,142.00€ dhe shpenzimet për tremujorin e vitit 2026 duken kështu, për paga dhe mëditje 6,551,947.00€, për mallra dhe shërbime 657,654.00€, për shpenzime komunale 272,163.00€, për subvencione dhe transfere kemi vlerën 109,680.00€, për investime kapitale kemi vlerën 1,695,698.00€.

po besoj që materialin e keni pranuar të gjithë me kohë dhe i keni të ndara në formë tabelore dhe të krahasuara me vitin 2025 të të shprehur edhe me përqindje, andaj ju falënderoj të gjithëve dhe jam e hapur për pyetje dhe komente.

z.Haki Rudari, theksoi, Kuvendi i Komunës apo Kuvendet Komunale janë organet më të larta në Komunë të cilat e kanë për obligim dhe e kanë për detyrë të bëjnë monitorimin e buxhetit dhe njëri nga mekanizmat kryesor të monitorimit është pikërisht edhe raporti apo raportimet financiare, e që përmes raporteve apo raportimeve financiare këshilltarët e Kuvendit por jo vetëm sepse edhe qytetarët informohen së paku për këto pasqyra.

Raport mbi të ardhurat dhe shpenzimet, të dhënat mbi investimet dhe detyrimet e Komunë, të dhënat mbi investimet kapitale dhe të tjera, pra thjesht raporti financiar apo raportimet e kanë anën e vet ku së paku kemi dy çështje kryesore që janë në demokraci, transparenca dhe llogaridhënia.

Në rastin konkret kemi një raport financiar tremujorët janar-mars 2026 ku shuma totale e buxhetit të Komunës është 34,778,954.00€, pra ne e kemi buxhetin të realizueshëm, buxhetin përfundimtar dhe kjo është buxheti fillestar, dhe nga ky buxhet në tremujorin e parë natyrisht kemi këto harxhime, totali i shpenzimeve është 9,287,142.00€ por ajo çka dua ta them është te investimet

kapitale që dua të ndalem e që shuma është 1,695,698.00€. Po ashtu kemi edhe shpenzime nëpër kode të ndryshme e shpenzimet sipas kodeve të ndryshme ajo çka bie prap në sy dhe e cila po përcillet vazhdimisht nëpër Kuvende Komunale sikurse që po e përcjellë edhe Kuvendin Komuna të Podujevës janë pagesat e përmbaruesve ose obligimet nga Kontrata Kolektive që unë edhe njëherë po e them se është obligim i cili rrjedh dhe daton nga muaji prill i vitit 2017 por që realisht po ka efekte negative edhe nëpër Komuna të ndryshme. 501,177.00€ janë harxhuar nga obligimet e Gjykatave vetëm për këtë tremujor e që është një shumë e madhe që natyrisht ndikon edhe në shqyrtimin por edhe në projekte të ndryshme.

Sa i përket harxhimeve të tjera natyrisht ne e kemi materialin dhe nuk dua të ndalem shumë por ajo që po dua të them është që në tremujorin e parë të gjithë e dimë se është një kohë kur ka edhe probleme klimatike e po ashtu është edhe kohë ku nuk mund ndoshta të dalin në tenderim projektet mirëpo besoj që në gjashtëmujorin apo nëntëmujorin e këtij viti do të kemi investime të shumta dhe raporti financiar sigurisht që do të vije me harxhime apo investime të ndryshme për arsye se kemi edhe rreth 9 milion euro ku Komuna jonë ka për obligim, ka për detyrë por fundja edhe këto projekte që janë në kuadër të Komunës janë në interes të qytetarëve.

z.Besim Latifi, theksoi, sot po diskutojmë raportin financiar për periudhën janar-mars 2026, raporti i parë financiar për këtë vit i cili paraqet të hyrat dhe shpenzimet në tremujorin e par të vitit. Sipas planifikimit buxheti për vitin 2026 është mbi 34 milion euro e që ky është një buxhet i lartë që do të duhej të ishte buxhet zhvillimor, mirëpo që në fillim të vitit bazuar në mënyrën e shpenzimit gjatë këtij tremujori shihet qartë se ky buxhet është fokusuar kryesisht në pagesat e borxheve të vitit 2025 në kurriz të projekteve të parapara me buxhetin e vitit 2026, e këto borxhe i kemi theksuar edhe në seancën e kaluar kur diskutuam raportin financiar të vitit 2025, dhe ky raport tani është një lloj vule e të gjitha shqetësimeve që i kemi ngritur, veçanërisht shqetësuese janë detyrimet financiare që vijnë në formë faturash të papaguara për punët e kryera në vitin 2025 pa asnjë arsytim përse nuk janë paguar. Këto borxhe do të duhej të mbylleshin në vitin fiskal 2025 dhe jo të barteshin si barrë në buxhetin e vitit 2026.

Shpenzimet e këtij tremujori në tërësi janë borxhe në formë të faturave dhe detyrime kontingjente nga vendimet e Gjykatave. Po ashtu vërehen edhe shumë shpenzime të tjera që janë shqetësuese për mënyrën se si kanë ndodhur. Do të ishte e kuptueshme që fillimi i vitit të ishte më shumë zhvillim i procedurave dhe lidhje e kontratave dhe më pak punë në terren për shkak të kushteve atmosferike, mirëpo kur analizojmë në detaje shpenzimet sipas kategorive ekonomike shohim me brengosje këto të dhëna.

Për të analizuar drejtë raportin dhen për të parë çdo pagesë që ka ndodhur unë kam marrë edhe kartelën analitike nga drejtoresha e DBF-së, krahasimi tregon dallime në mes të dy dokumenteve zyrtare, raporti financiar dhe kartelës analitike të shpenzimeve, e që kjo nuk do të duhej të ndodhte sepse ky në fakt e bënë raportin të pabesueshëm, por megjithatë unë dua të besoj që kemi të bëjmë me lëshime teknike.

Tani do të fokusohem në disa pjesë të raportit që kanë të bëjnë me shpenzimet e realizuara gjatë këtij tremujori sipas kategorive ekonomike. Shpenzimet për mallra dhe shërbime buxheti i planifikuar për vitin 2026 në këtë kategori ka qenë 3.7 milion euro ndërsa shpenzime janë bërë 657,654.00€ ose 18% , e që krahasuar shpenzimet me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar vërehet një rritje e konsiderueshme në disa kategori, te kodi 13140 transport për udhëtime jashtë vendit janë 1850€ ndërsa në vitin e kaluar kanë qenë zero euro, te kodi për akomodim dhe udhëtime zyrtare brenda vendit janë 13,708.00€ shpenzime këto të cilat janë të konsiderueshme dhe shqetësuese andaj për këtë arsye unë dua t'i shtroj disa pyetje se kush janë zyrtarët që kanë përfituar nga këto akomodime, cilat kanë qenë arsyet e këtyre udhëtimeve dhe cilat janë përfitimet

konkrete të Komunës. Pastaj te kodi 13142 akomodim dhe udhëtime zyrtare jashtë vendit kemi 5814€ ose 84% më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit 2025. Te kodi 13250 telefonua fikse 3314€ ndërsa në vitin e kaluar shpenzimi ishte zero euro, mandej te kodi 13440 shërbime këshillëdhënëse dhe profesionale janë 18,000.00€ ose 1402% më shumë se në vitin e kaluar, andaj pyes cilat janë këto shërbime dhe cilat janë përfitimet e Komunës nga këto shërbime. Te kodi 13445 shërbime të veçanta intelektuale dhe konsullore janë 3793€ ose 74.87% më shumë se sa në vitin 2025.

Një diçka interesante që nuk e pash që ka në raport të pasqyrave të vitit 2025 ishte shtesa e performancës ku janë shpenzuar 1,250,000.00€ e që është diçka e pakuptueshme dhe pa asnjë sqarim andaj nuk po mund ta di kush ka përfituar prej kësaj shtese. Mandej te kodi 13620 në raport figurojnë 31,800.00€ për furnizim me ushqim dhe pije ndërsa në shkollat e Podujevës nga muaji janar, do të thotë nga fillimi i gjysmë vjetorit të dytë fëmijët nuk janë furnizuar me kifile, pra kam pranuar shumë vërejtje nga qytetarët për ato kifile, andaj çoni kiflet në shkollë sepse fëmijët janë duke i kërkuar, përndryshe në raport financiar po figuron shpenzimi ndërsa furnizimi nuk është duke ndodh. Te kodi 13460 shërbime kontraktuese tjera janë mbi 130,000.00€ apo 115% më shumë, pra kemi një mbi dyfishim të shpenzimeve, çfarë ka ndodh përse kjo rritje e menjëhershme. Te sigurimi i objekteve publike kemi 75% më shumë se në vitin e kaluar, do të thotë edhe kjo është një diçka e paarsyeshme. Derivate për automjete dhe gjenerator kemi 170% më shumë, ose në shumë totale 26,994.00€ e që do të thotë se ne jemi të vetëdijshëm se ka qenë një rritje prej 50% - 60% e çmimit mirëpo këto shpenzime ju janë rritë 170%. Mandej kemi kodin 14160 qiraja e automjeteve është rreth 3000€ ndërsa në vitin e kaluar ka qenë zero. Pra këtu vie në pah ajo që u tha në seancën e kaluar nga drejtoresha se marrja e veturave me qira është më e leverdishme se po na del më lirë, prandaj kjo shifër e demantoi atë pretendim dhe këtë i'a kam treguar edhe në seancën e kaluar.

Gjithashtu te qiraja për tokë janë 44,362.00€ ose 1009% më shumë, sipas raportit. Gjithashtu bie në sy një, pagesë interesante që është gjoba ndërinstitucionale, në shumën prej 1550€. Nga kartela analitike e shpenzimeve, por edhe një ditë më parë gjatë diskutimeve në KPF e pamë që këtu janë bërë pagesa të gjobave të Policisë, diçka e paprecedent e që do të thotë se kjo është papërgjegjësi totale sepse kenë vozitë vetura zyrtare pa sigurim dhe i keni rrezikuar punonjësit e Komunës, punonjësit e shëndetësor, zjarrfikësit dhe gjithë pjesëmarrësit në trafik, për besë është skandaloz.

Shpenzimet komunale, Buxheti i planifikuar për vitin 2026 ka qenë mbi 694,000.00€, ndërsa janë shpenzuar 272,000.00€ ose rreth 40%, pra vetëm për tre muaj 40%, e kjo nënkupton se për nëntë muajt e mbetur kanë mbetur vetëm rreth 61% buxhet në këtë kategori, andaj ky trend është shqetësues dhe rrezikon që sikurse në fund të vitit 2025 edhe në muajt e fundit të vitit 2026, të mbesim përsëri pa ndriçim publik për shkak të mungesës së mjeteve në këtë kategori.

Shpenzimet kapitale, kanë qenë të planifikuara mbi 8 milion ose sakt 8,757,000.00€ ndërsa janë shpenzuar 1,695,000.00€ ose 19.7% e që në shikim të parë kjo përqindje duket e pranueshme, por analiza tregon se rreth 30% apo 501,000.00€ janë paguar për vendime gjyqësore. Kjo është shqetësuese sepse tregon këto pagesa ndërlidhen me detyrime kontingjente dhe borxhe të mëhershme, pastaj është shqetësuese se këto pagesa janë realizuar vetëm nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, prandaj dua t'i shtroj disa pyetje; pse këto vendime janë ekzekutuar vetëm në këtë Drejtori, pastaj nga cilat projekte janë marrë këto pagesa. Gjithashtu të gjitha pagesat për investime kapitale janë realizuar në tri data, më 25, 27 dhe 31 mars, gjë që tregon mungesë planifikimi financiar.

Te të hyrat vetanake, në aspektin pozitiv, të hyrat nga hapësirat publike të dhëna me qira janë inkasuar 84,000.00€ ose 56% e planit, kjo është mirë, kurse në aspektin negativ, inkasimi nga tatimi në pronë është vetëm 7% nga plani, ose 51% më pak se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo besoj se është shqetësuese.

Si përfundim, ky raport financiar për periudhën janar–mars 2026 karakterizohet nga rritja e shpenzimeve rrjedhëse, bartje e borxheve nga viti 2025, zvogëlim i investimeve kapitale, dhe pagesa të konsiderueshme për vendime gjyqësore, prandaj si opozitë, kërkojmë më shumë transparencë, më shumë përgjegjësi dhe menaxhim më të mirë të parasë publike.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, raporti tremujor financiar janar-mars 2026, më duhet një përgëzim të vogël për drejtoreshën e DBF-së që tabelën dhe raportin e ka sjellë më të kthjelltë se sa herëve tjera që ka ardhë dhe po ashtu është më i qartë, edhe pse ka mangësi por është më i mirë se herëve tjera. Unë si zakonisht disa pagesa që janë më të paqarta ose që janë më të pa nevojshme, po filloj prej veturave me qira 3253€ do të thotë nuk e di dhe madje edhe në mbledhjen e kaluar e potencova, por nuk e di çka po na duhen këto vetura t'i marrim me qira kur institucionet kanë mjaftë vetura, dhe sa po shkojnë harxhime për mirëmbajtje, për derivate dhe plus të paguhet edhe për qira, mua më duket goxha shumë. Pastaj çka mu duk si shumë ishte qiraja për Parkun e Paqes, unë e di që paguhet fatura dhe është me qira që i paguhet Infracosit, por për 3 muaj 38,750.00€, nëse neve na kushton për çdo vit kaq shumë të paguajmë qira, a mund të ketë ndonjë metodë tjetër që të sjellët në Kuvend që ta votojmë si interes të përgjithshëm dhe ta marrim atë pronë e jo të paguajmë qira aq shumë sepse vërtetë është shumë e madhe kjo shifër edhe pse nuk po e di a ka qenë borxh i vitit të kaluar apo vetëm në këtë tremujorë të parë të këtij viti janë paguar 38,750.00€ që është shumë e madhe si qira.

Pastaj kemi për shërbime kontraktuese tjera 150,473.00€ edhe kjo është shumë e madhe, pastaj një tjetër që më bërë përshtypje është, shërbime me dokumente bllanko, shembull në vitin 2025 në këtë tremujor janar-mars kemi paguar 2275€ kurse në të njëjtën periudhë në vitin 2026 janë paguar 12,876.00€ për shërbime me dokumente bllanko e që edhe kjo është shumë shifër e madhe. Mandej ajo që e vërejta ishte edhe dreka e fund vitit, pati shumë fatura të drekave zyrtare, por 9000€ ishte dreka e fund vitit, tani duke e ditë sa punëtor i ka Komuna dhe duke e ditë që nuk ka shans që të shkojnë të gjithë, rreth 270-280 punëtor, të llogaritet për një person nga 25 euro prap nuk del, nga 30 euro nuk del, nga 40 euro shumë, prandaj 9000€ janë shumë për një darkë, e dim që njëherë gjatë mandatit të kaluar jemi ftuar edhe ne anëtarët e Kuvendit kurse më asnjëherë nuk është marrë askush me neve, jo që më mbetet merak të shkoj por 9000€ të paguhet drekë, mirëpo kishte edhe 2-3 fatura tjera të paguara me të njëjtën datë por nuk kuptohet këtu a janë ndarë faturat apo çka sepse nëse është mbajtur në restorant Ora darka e fund vitit dhe janë paguar 9000€, në atë ditë të bëhet pagesë tjetër shtesë shembull edhe 160€ tjera dhe të shkohet nga aty në një tjetër restorant edhe aty pastaj rreth 500€, tani këtu ja i bie që ka filluar të pijë dikush aty dhe ka shkuar e ka vazhduar diku tjetër, pra janë shumë.

Te gjrobat, edhe kjo kërkon një sqarim sepse tani këtu janë 1550€ gjoba që ka paguar Komuna, pra a është dënuar shoferi apo është dënuar Institucioni, çka ka ndodh me këto gjoba sepse kishte gjobë 500€, 200€, 150€, pra janë disa gjoba.

Shërbime këshillëdhënëse, shembull në këtë periudhë të vitit 2025 janë paguar 1250€, kurse në vitin 2026 janë paguar 18,782.00€, nuk po di a ka “blerë mend” këtu ndokush apo çfarë shërbimi është ky, shërbim këshillëdhënës, pra mu duk shumë interesant. Po ashtu kemi mirëmbajtjen e rrugëve ishte një shifër 147,845.00€, unë nuk e di cilat rrugë po mirëmbahen mirëpo vetëm pasluftë kur kanë qenë rrugët e këqija që i patën prishur tanket, kurrë më keq rrugët në Komunën e Podujevës nuk kanë qenë, madje e pash duke ardhë këtë rrugën prej QKMF-së e këndeje nuk e dija

a ka hyrë ndokush të prashit apo çka ka ndodh, nuk e di qysh hapet gjithë ajo grop aty, as nuk ishte pastruar aj vend as asgjë, ishe bërë tmerrik sikur në Kandahar, andaj nuk e di çfarë mirëmbajtje apo kush i mirëmban këto rrugë kështu, por kurrë në jetë rrugët më keq nuk kanë qenë, as nuk ka shakta në vend, madje disa gropa që i kanë mbyll gati më keq janë tani se sa kanë qenë por atëherë e ke ditë të paktën që po kalon për një ndërprerje, kurse tani sikur kur bie nga qielli me veturë është në ato gropa.

Pra i dua përgjigjet për këto çështje që i ngrita sepse pastaj nëse ne vijmë i themi dhe nuk ka përgjigje i bie që ne po gënjejmë ose diçka të ngjashme, kështu që për të gjitha këto që i ceka i dua përgjigjet dhe pastaj ballafaqohemi. Këto pagesa janë bërë dhe unë mund t'i dokumentoj sepse i kam komplet faturat se qysh janë bërë, prandaj të del drejtoresha e DBF-së apo kushdo qoftë të thotë se nuk është ashtu, pastaj unë e pranoj.

znj.Qëndresë Hajrizi, theksoi, raporti financiar janar-mars 2026 të cilin e kemi para vetës paraqet një pasqyrë reale të menaxhimit financiar për tremujorin e parë të vitit dhe dëshmon për një qasje të kujdesshme të qeverisjes tonë. Nga të dhënat shihet se buxheti i përgjithshëm arrin mbi 34 milion euro ku pjesa më e madhe përbëhet nga pagat dhe mëditje, mallrat dhe shërbimet, investimet kapitale. Vetëm për tremujorin e parë janë shpenzuar rreth 9.28 milion euro që është një nivel i qëndrueshëm dhe i planifikuar i realizimit. Në veçanti investimet kapitale arrijnë vlerën mbi 1.6 milion euro e që tregojnë se fokusi ynë mbetet në zhvillim dhe përmirësim të infrastrukturës dhe shërbimeve për qytetarët.

Është e vërtetë se investimet kapitale në tremujorin e parë të vitit në përqindje janë më ulët por kjo është plotësisht normale në këtë fazë të vitit dhe realizimi i tyre rritet në tremujorin vijues.

Nëse i referohemi të hyrave vetanake shohim një rritje të dukshme nga 314,000.00€ në vitin 2025 në 386,000.00€ në vitin 2026 e që përbën një rritje rreth 23%, kjo tregon qartë një angazhim më të madhe dhe një performancë më të mirë në mbledhjen e të hyrave.

Po ashtu te taksat komunale kemi rritje të konsiderueshme nga rreth 126,000.00€ në 175,000.00€ e që është një rritje mbi 38%, kjo dëshmon për menaxhim më efikas dhe rritje të disiplinës financiare. Gjithashtu kemi edhe rritje të dukshme edhe në disa kategori kryesore krahasuar me vitin paraprak, ngarkesat komunale janë rritur ndjeshëm mbi 100% duke treguar përmirësim në menaxhim dhe inkasimin e obligimeve.

Të hyrat nga qiraja e pronave komunale kanë shënuar rritje shumë të madhe çka tregon shfrytëzimin më të mirë të asetëve komunale dhe efikasitetin më të lartë në administrim.

Natyrisht ka edhe disa kategori ku ka rënie siç është tatimi në pronë apo në disa shërbime administrative por këto janë të menaxhueshme dhe nuk e ndryshojnë faktin që raporti është pozitiv. Është e rëndësishme që nuk kemi tejkalime të pakontrolluara por kemi disiplinë buxhetore dhe orientim të qartë drejt prioritetëve, prandaj si Grup i LVV-së e konsiderojmë këtë raport si të balancuar, transparent dhe në fokus të interesit publik dhe e mbështesim atë.

z.Valdet Restelica, theksoi, atëherë ky raport financiar për periudhën janar-mars duhet të jetë raport i zhvillimit dhe i investimeve kapitale, por nëse e analizojmë në detaje shohim që është një raport që është merre me larjen e borxheve të vitit 2025, pra përdorim qytetarët për zhvillim dhe investime këtu kemi të bëjmë me larje të borxheve.

Do të doja nga drejtoresha e DBF të më jap disa sqarime për disa shifra të cilat i kam nxjerrë e që është një diskrepancë te disa shpenzime të cilat kanë ndodh në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2025, fjala është te kodi 14120 që është qiraja për tokë në shumë 44,362.00€ e nëse e krahasojmë me përqindje është 1009% më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, pastaj kemi kodin 13760 për dru dhe prodhime të drurit për ngrohje që janë 67,201.00€ ndërsa në vitin e kaluar ka qenë zero euro, andaj do të donim ta dimë pse ka ndodh kjo. Mandej kemi kodin

13440 për shërbime këshillëdhënëse dhe profesionale në shumë 18,782.00€ e që është një shumë, shumë e madhe, ndërsa nëse krahasojmë atë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar i bie 1402% më shumë e që është një diskrepancë shumë e madhe. Pastaj kemi për shërbime të veçanta intelektuale në shumë 3793€ ose në përqindje 74% më shumë.

Një pikë tjetër ka qenë edhe sa i përket udhëtimeve zyrtare jashtë vendit që është kodi 13142 në shumë 5814€ e që do të doja ta di se çka kanë përfituar qytetarët prej këtij udhëtimi dhe cilat ka qenë produktiviteti i tij ose ta dim pak më sakt.

Edhe te shërbimet kontraktuese kemi 115% më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, Mandej te dokumentet bllanko është 466%, pra kryesisht janë shumë shumë më të larta. Kemi edhe darkën e fund vitit që e ceku edhe parafolësi kolegu z.Ekrem Rrahmani, në shumë 9000€ e që më duket goxha shumë, drejtorët në seancën e kaluar na thoshin nuk o shumë, por unë mendoj dhe neve na duket se është shumë sepse 9000€ sepse në një mënyrë duhet të kemi kujdes se qysh e shfrytëzojmë paranë publike që është para e qytetarëve.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, unë i kuptoj anëtarët e LVV-së se e kanë për detyrë për ta mbrojtur raportin financiar pavarësisht a mund të ketë të meta apo jo, e kuptoj se mund t'iu duket si një fushë me lule, mirëpo nuk mund t'i mbyllim sytë para faktit, që shembull po themi që janë bërë pagesa për mirëmbajtje rrugore ashtu qysh e ceku edhe kolegu parafolës z.Ekrem Rrahmani, seriozisht mendoj se rrugët kurrë më keq nuk kanë qenë dhe nuk e di ku po mirëmbahen ato rrugë. Gjithashtu e njëjta vlen edhe te ndriçimi publik ku me gjitha të pagesë që është bërë ka shumë defekte, madje në secilën rrugë që hyn ka defekte sa i përket ndriçimit publik.

E kam parë edhe te pjesa e free-balance që ka pagesa të gjobave prej Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, a mund ta dim pse janë bërë ato pagesa, nëse janë bërë shembull për faktin që veturat nuk kanë qenë me sigurim atëherë pse të paguajnë qytetarët atë pjesë të gjobës, përndryshe në i'u rrimë gati veturave tona për të mos u gjobitur kurse në anën tjetër t'iu paguajmë gjoba të drejtorisë, kjo nuk është normale.

znj.Gresa Qosa-Maqastena, theksoi, te raporti financiar janar-mars shihet që keni planifikuar ose janë rregulluar e ndërtuar rrugë, por nuk janë të precizuara emërtimet e rrugëve, gjithashtu mungojnë edhe gjatësia me kilometra e metra sa menduar t'i shtroni, kështu që besoj se do të duhej të ishin më të pasuruara edhe me emërtime e jo kështu ku në raportin financiar tremujor të thuhet vetëm, në këtë fshat disa rrugë, në atë fshat disa rrugë, e që nuk po kuptohet a janë rrugë kryesore, a janë dytësore apo ndonjë oborr që e keni shtruar ose rrugicë, prandaj atë që e keni planifikuar është dashtë ta precizoni këtu në raport kryesisht.

Gjithashtu po shohë që në raportin financiar janë 96,000.00€ më shumë te arsimit fillor që janë paraparë të rinovohen objektet ku fillimisht e keni shkruar vetëm shkollën "Naim Frashëri" meqë kemi mbete paksa tek kjo shkollë sepse ka nevojë pak më shumë të mbikëqyret kurse tjerat shkolla mungojnë se ku do të kryhen rinovime, kështu që të jeni pak më preciz dhe serioz. Besoj se te rinovimi i objekteve ju keni pasë nja 38 gjëra që ju keni thënë gjatë fushatës që i keni premtuar për gjëra më të mira të shkollës kurse tani po ktheheni prap tek rinovimet dhe ku arrijnë shifra deri në 100,000.00€, kështu që na jepni paksa mundësi të dim edhe ne se çka jeni duke bërë me ato mjete.

z.Ermal Osmani, theksoi, sa i përket raportit financiar për periudhën janar-mars 2026, te kategoria e shpenzimeve komunale janë shpenzuar në masë të madhe ku prej tyre janë 40% në këtë tremujor të parë. Duke llogaritur se kanë mbetur deri në fund të vitit edhe 9 muaj për këtë kategori në fund vit nuk janë të mjaftueshme, ndërsa ne jemi dëshmitar që për shkak të mos pagesës së energjisë elektrike në 2 apo 3 muajt e fundit të vitit 2025 është ndërprerë energjia elektrike dhe ndriçimi publik në territorin e Komunës së Podujevës, madje kjo ka ndodhë edhe në sheshin e qytetit tonë ku kemi pasë edhe ankesa nga qytetarët për mos ndriçim publik në territorin e Komunës së

Podujevës. Pastaj në këtë kategori janë edhe Brigadat e Zjarrfikësve ku gjatë sezonit të dimrit nuk i keni furnizuar Brigadat e Zjarrfikësve me pelet dhe ata janë detyruar të marrin nxemje nga shtëpitë e tyre për t'u nxehur në objektin ku veprojnë dhe punojnë, situat kjo e cila nuk është aspak e hijshme të ndodh në Komunën e Podujevës në këtë kohë periudhe të dimrit.

znj.Arbnorë Uka-Osmani, U.D. drejtoresh e DBF, theksoi, falënderoj të gjithë për komentet dhe pyetjet shitesë dhe në vazhdim po provoj të përgjigjem me rend.

Siç e dini ne si Drejtori kemi qenë nga fillimi por edhe në të kalurën dhe të tashmen transparent dhe për çdo pagesë jeni të lirë të na shkruani dhe ne do t'ju përcjellim komplet dosjen qoftë në mënyrë elektronike qoftë në mënyrë fizike.

Sa i përket kodit 13142, më duhet nga pak kohë të kuqem në Llaptop të marrë informata sepse është e pamundshme të mbaj mend të gjitha, pagesat që janë bërë për udhëtime zyrtare, akomodim dhe pije, janë tri pagesa gjithsejtë dhe këto i përkasin pagesave të vitit të kaluar, pra jemi duke i përsëritur vazhdimisht komentet se në vitin 2025 ka qenë vlera janë marrë me vendime Gjyqësore 3.7 milion euro dhe këto para nuk janë marrë vetëm prej një programi apo kategorie por janë marrë në kapitale, mallra dhe shërbime, janë marrë në komunale dhe janë marrë në subvencione, dhe ato projekte dhe ato fatura ose investimet që janë bërë kanë mbetur pa u paguar dhe këto i kemi prezantuar në raportin e vitit 2025 si fatura të papaguara, kurse tani me aprovimin e buxhetit, në fillim të vitit 2026 siç e dini, për ata që nuk e din po e përsërisë se janari dhe shkurti kanë qenë vetëm shpenzime rrjedhëse, do të thotë ka qenë 1/12 pjesë e buxhetit të vitit paraprak, kështu që për atë arsye janë bërë pagesa veç për mallra dhe shërbime. Pastaj pati komente këtu që pse janë realizuar te shpenzimet kapitale vetëm prej datës 27, natyrisht se nuk kemi pasë mundësi më herët sepse edhe ne kemi pasë vullnet që t'i realizojmë më herët, kështu që për ata që nuk e dinë disa komuna ende nuk kanë filluar me realizim apo me procesim të pagesave te investimet kapitale, kjo për shkak të pamundësisë prej thesarit të kodeve të cilat nuk i kanë hap ende ata, por fatmirësisht te Komuna e Podujevës kjo ka ndodhë në fund të muajit mars dhe për atë arsye kemi realizuar te investimet kapitale disa pagesa, do të thotë këto pagesa që i keni përmendur pothuajse 90% janë fatura të papaguara të vitit 2025.

Edhe diçka t'ju them se ne kemi një plan kontabël para vetës i cili është i vitit 2025, e them këtë sepse dje në mbledhjen e KPF-së pati pyetje se a kemi plan tjetër kontabël, nuk kemi sepse zakonisht planet kontabël bëhen për çdo 4 vite varësisht qysh e sheh Thesari, dhe fatkeqësisht ka shumë mungesa te përshkrimi i shpenzimeve, jemi të detyruar që disa shpenzime t'i grumbullojmë dhe për atë arsye në raport financiar dalin si në këtë rast shpenzime këshillëdhënëse apo kontraktuese, e aty përfshihen një mori e ndryshme e shpenzimeve dhen kjo për shkak të mungesës së planit kontabël, ai ka nevojë të pasurohet ende mirëpo nuk është përgjegjësi e Komunës për ta bërë pasurimin e planit kontabël.

Pra po filloj me kodin 13440 sepse ishte një vlerë pak më e madhe, këtu kemi hartim të projekteve dhe ekspertizë vlerësuese të pronave, pra të gjitha janë shpenzime që i përkasin vitit 2025, do të thotë në total janë 6 pagesa dhe këto përderisa janë në kategorinë e mallrave janë kryer me kohë në momentin që është aprovuar buxheti. Pastaj u përmend shtesa e performancës, fatmirësisht është vitit i parë që të gjitha kategoritë që marrin paga prej Shtetit e kanë marrë edhe pagën e 13-të kështu që kjo është një diçka për t'u përgëzuar që ka filluar si nismë në këtë vit dhe do të vazhdoj edhe në vitet e ardhshme, pra kjo është shtesa e performancës që është përmendur 1.2 milion euro, i përket kësaj kategorie. Mandej te kodi 13460 edhe këtu ka një dallim është një kod sipas planit kontabël përderisa asambleistët e përmendën me kode, atëherë këtu kemi një mori të shpenzimeve të ndryshme, kemi nëpër Drejtori të ndryshme dhe kryesisht janë mallra dhe shërbime, kemi pagesa për mirëmbajtje, për trajtimin e qenve endacak, largim i objekteve mirëmbajtje e sistemit të

ujitjes dhe pagesa të tjera që shumica siç e ceka janë të vitit 2025, një pjesë janë edhe të vitit 2026 kuptohet sepse kemi pasë edhe shpenzime që janë realizuar në këtë vit dhen që janë paguar me kohë. U përmend edhe kodi 14450, dhe atë 2-3 herë e që ka të bëjë me gjobat që pse kemi marrë gjoba si institucion, kjo për shkak se arsyeja e mos rexhistrimit të veturës në këtë rast është vetëm për veturat në QKMF dhe ato janë autoambulancat që fatkeqësisht në mungesë të buxhetit nuk kemi arrit t'i rexhistrojmë me kohë kurse në anën tjetër ata kanë qenë të detyruar të kryejnë punën sepse në radhë të parë si prioritet për të gjithë neve është mbrojtja e jetës së qytetarëve, kuptohet se edhe ajo nuk është mirë të ndodh mirëpo ka ndodh për shkak të vendimeve Gjyqësore e që nuk kemi pasë mjete të paguajmë as sigurimin e veturave, andaj ka pas gjoba dhe ato gjoba janë paguar sigurisht nga Institucioni e jo nga vozitësit.

Sa i përket komunalive që u tha se pse kemi mungesë të mjeteve buxhetore, po pajtohem plotësisht ngase siç e dini në këto vite janë bërë investime të mëdha edhe në ndriçim publik, edhe në renovime e ndërtim të objekteve të ndryshme shkollore apo objekte tjera, dhe fatkeqësisht nga Thesari nuk është bërë ndryshimi, apo thënë ndryshe kur neve na vie Qarkorja Buxhetore nuk është bërë ndryshimi konform investimeve dhe zgjerimit të investimeve që të rritet edhe shuma totale e shpenzimeve komunale, do të thotë kjo nuk ka ndodh por po shpresojmë që në këtë vit do të reflekton edhe buxheti edhe do të rrisë shumën për komunalin për shkak që siç e dini qysh ka ndodh edhe në vitin e kaluar është rreziku që edhe në këtë vit në fund të vitit të mbesim pa pagesa, do të thotë të ketë mungesë të pagesave për këto kategori.

Te kapitalet, një pjesë siç e përmendi edhe shefi i Grupit të LVV-së është vlera 501,000.00€ që janë marrë për vendime Gjyqësore deri tani e që edhe kjo ka qenë e pasqyruar në raport financiar si obligime të papaguara e jo detyrime kontingjente, mirëpo obligime të papaguara të cilat kanë qenë të evidentuara dhe me këtë rast Thesari i ka marrë mjetet prej asfaltimit të rrugëve në qytet, pra në këtë rast Thesari ka përdorë metodën që vetëm te projekti më i madh, do të thotë në atë projekt i ka marrë ato mjete e ne e kemi pasë projektin më të madh që ka qenë asfaltimi i rrugëve në qytet në vlerë 620,000.00€ dhe në këtë rast shuma e ngarkuar për këtë periudhë ka qenë 502,000.00€ për afërsisht dhe Thesari ka vendosë që në atë projekt t'i marrë mjetet.

Është përmendur pagesa e qirasë për Infrakos, të gjitha këto siç e dimë pagesa mujore për qira Infrakosit është afërsisht 5000€ mirëpo është edhe obligimi i vitit 2025 që nuk kemi arritur ta paguajmë me kohë për shkak të mungesës së fondeve.

Pastaj disa herë u përmend pagesa prej 9000€ për darkën e fund vitit, në fakt pajtohem që si vlerë tingëllon shumë dhe është e papranueshme, mirëpo nëse hyjmë në analizë më në detaje e që jeni të gatshëm të vini, dhe këtë po e përsërisë se çka do që ju intereson mund të vini në Drejtori dhe të merrni çfarëdo informate që ju duhet qoftë në mënyrë verbale qoftë në formë të shkruar fare nuk ka problem, pra do të thotë vlera 9000€ është për shkak se ka qenë 300 persona, dhe kjo nëse përpjesëtohet i vie 30€ për person e që nuk është shumë. Siç e dini ne me Rregulloret tona të brendshme nuk kemi të drejtë të paguajmë alkool, por veç pije tjera, andaj këto janë bërë konform ligjeve dhe rregulloreve që kemi ne.

U shtrua edhe pyetja pse janë bërë pagesa për renovime, siç e dim edhe këto pagesa janë bërë për shkak të obligimeve që kemi pas prej viteve të kaluara, por nuk do të thotë që renovimet përfundojnë me një renovim, prandaj punët e renovimeve janë vjetore për shkak se vazhdimisht ka dëmtime dhe nevojitet të rinovohen dhe të blihen edhe pajisje dhe asete tjera.

Po besoj se i kemi përmbledhë të gjitha por nëse kemi harruar diçka atëherë jemi të hapur të përgjigjemi sërish dhe të japim sqarimet e nevojshme.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, falënderoj drejtoreshën parafolëse për përgjigjet mirëpo mua nuk mbush mendja në dai pak, shembull ishte çështja e darkës së fund vitit, pse 300 persona, nëse komuna thuhet që i ka 285 të punësuar, unë ju garantoj as 220 prej tyre nuk kanë qenë (10 anëtar të një shtëpie po të jenë dhe të ftohen të gjithë në dasmë, të gjithë nuk shkojnë), prandaj nuk mund të më bindësh që kanë qenë 30 persona në atë darkë, mirëpo nëse ka pasë të ftuar edhe jashtë Komune atëherë diçka tjetër, por kjo ka qenë darka e fund vitit për punëtorët e Komunës e këta 283 janë krejt, nuk e di qysh bëhen 300, nuk e di nuk i kam parë.

Pastaj ishte çështja e mirëmbajtjes, unë nuk e kuptoj mirëmbajtjen e sistemit të ujitjes, mirëpo ne e dim që një sistem i ujitjes është në sheshin e Qytetit ku janë disa gypa për ujitje dhe asnjëherë nuk i kam parë askënd duke i mirëmbajtur, madje edhe nëse janë mirëmbajtur gjithë ata gypa më shumë se 1000€ nuk kushtojnë me gjithë gypat dhe pajisjet tjera, andaj do të thotë se edhe kjo është pagesë shumë pa lidhje.

Po ashtu edhe një gjë dua të përmend edhe pse kam vendosur që sa më pak ose fare të përmendi emra, por këtë pa qare dua ta përmendi, fjala është për Shqipdon Rushiti, kush është ky person dhe çka ka bërë ky për Podujevën që t'i jepen 3000€, pse duhet të përfshihet veç pse është LVV, duhet të dërgohet komisioner te votat, duhet të caktohet në komisione të ndryshme këtu për pronat që i japim në shfrytëzim, pastaj duhet të jepen subvencion 3000€, është me krah ky person apo çka ka, pra duhet t'ju shpjegohet qytetarëve pse ai person merr 3000€, a pse është i hijshëm apo çka.

z.Besim Latifi, theksoi, nga përgjigjet e drejtoreshës parafolëse të DBF mund të them se e mora një konfirmim për krejt ato çka i ceka në fjalimin tim paraprak, madje gjatë përgjigjeve më shumë keni dhënë përgjigje për raportin financiar të vitit 2025 se sa për raportin e tremujorit 2026.

Ne diskutojmë që shpenzimet të cilat kanë ndodh në kategorinë e investimeve kapitale prej 501,000.00€ ku për detyrimet kontigjente sipas vendimeve të Gjykatave janë marrë vetëm nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit e që i ke të pasqyruara edhe në raport, mirëpo mos i ngatërroni këto sepse në vitin 2025 ke pasë detyrime kontigjente dhe i keni paguar, mandej keni detyrime kontigjente edhe në vitin 2026 që jeni duke i paguar, keni detyrime në formë të faturave të cilat i kemi cekë edhe në mbledhjen e kaluar që ishte 1.6 milion euro që janë në raportin financiar të cilat janë bartur si detyrime në vitin 2026 nga vitit 2025, prandaj kjo tregon që këto pagesa të cilat janë duke ndodhur ose që kanë ndodh në periudhën janar-mars 2026 janë kryesisht obligime ose borxhe për ta thënë thjesht, prej vitit 2025 e jo që ka ndodh ndonjë aktivitet ekonomik ose ndonjë investim me këtë buxhet të caktuar e që në fakt unë e caka paraprakisht që periudha e parë e vitit janar-mars për shkak të kushteve atmosferike zakonisht më shumë është zhvillim i proceduarve se sa mundësi për zhvilluar punë.

Po ashtu edhe tek çështja e cekur nga drejtoresha parafolëse, shtesa e performancës është e rregulluar me ligj se qysh jepet, është kategori e pagës së 13-të dhe veç i gëzofshin të gjithë, mirëpo unë besoj që ajo duhet të jetë tek pagat e jo tek shtesa e performancës sepse ajo është pagë e jo shtesë e performancës, pra këto dallojnë, por mirë që tani paga e 13-të është kategori ligjore dhe hyn te kategoria e vet, jo te shtesa e performancës sepse kjo i'u jepet një kategorie të caktuar të personave për shkak të disa kushteve që i plotësojnë dhe një performancë të lartë.

znj.Gresa Qosa-Maqastena, theksoi, drejtoresha e DBF e ritheksoj disa herë (për ata që nuk e din për ata që nuk e din) ju zonja drejtoresh jeni drejtoresh e DBF dhe jeni e obliguar të jepni sqarime për të gjitha ato paqartësi që kemi në raporte me raportin financiar, janë disa gjëra të cilat në terren nuk duken por që këtu janë të pasqyruara në raport financiar andaj këto janë edhe pyetje të qytetarëve e që gjithashtu të ritheksoj dhe ta rikujtoj se jo të gjithë qytetarët janë ekonomistë dhe kuptojnë prej financave, kështu që këto paqartësi janë edhe pjesë e pyetjeve të qytetarëve, andaj

kjo pjesa që e theksuar disa herë, për ata që nuk e din, po më duket paksa e tepërt për të pyetur sepse e ke marrë funksionin e drejtoreshës jenë në Drejtori dhe duhet të japësh sqarime për krejt ato gjëra të cilat janë të paqarta edhe për ne për të cilat marrim pyetje prej qytetarëve.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH, theksoi, më bëri përshtypje z.Ekrem Rrahmani të cilit tani po i'a përmend emrin që të ketë mundësi të marrë fjalën sërish, sa i përket mirëmbajtjes së sistemit të ujitjes për çka e përmendi vetëm sheshin e qytetit apo vetëm qendrën e qytetit që ka sistem të ujitjes por që njëherë pati thënë këtu që “unë e mbyllim Komunën / qytetin kur të dal prej këtu”, mirëpo ndoshta nuk është mirë të bazoheni vetëm në shesh por duhet të dalësh ngapak edhe në periferi, e sa për njoftimin e juaj po ju tregoj se sistem të ujitjes përveç sheshit është edhe sistemi i drunjtëve përreth lumenjve që e kanë sistemin e ujitjes, mandej në këtë kemi edhe fontanat e qytetit tyë cilat kërkojnë një kosto goxha të madhe të mirëmbajtjes sepse siç e dini janë disa fontana goxha të avancuara dhe të modelit të fundit.

Përveç kësaj projekti që është shumë i rëndësishëm dhe që është prej projekteve më të mëdha të sistemit të ujitjes, dhe këtu paksa po i përzihem Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural meqë e kam fjalën tani, është sistemi i ujitjes në fshatin Lupç, që ka një kosto shumë të lartë ku është duke u bërë sistemi i ujitjes. Pra gjitha këto janë sisteme të ujitjes që edhe ndërtohen dhe mirëmbahen i nderuar Ekrem, nuk është vetëm sheshi, mirëpo si do që të jetë është e jona t'ju njoftojmë sepse për ata që nuk i dinë në fakt sepse ka që e dinë, por për ty Ekrem që se paske ditë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuar drejtor parafolës, tani fillimisht po jua dëshmoj se dal për çdo ditë në qytet, ato fontana që i kemi ndërtuar ne e që po thua se janë moderne, asnjë ditë nuk ju kanë funksionuar kurrë, dy fontana i kanë dy multi pompa nga 35 euro të cilat kushtojnë “Te Zena” këtë e them sepse e kamë në shtëpi dhe e di sa kushtojnë të blihen krejt komplet. Pastaj asnjë gyp këtu në qytet nuk është ndërruar dhe nuk është mirëmbajtur, madje asnjë herë as një pip i gypit nuk është ndërruar. Te “Kafaj e Bahri Hotit” e ke një gyp ku rrjedh uji dhe sa herë të kalosh andej ke rrjedhje të ujit, pastaj ka edhe tjerë të cilët nuk funksionojnë dhe që kurrë asnjëherë nuk i ka shikuar askush. Kam reaguuar në facebook, në të nxehtit më të madh rreth fundit të muajit gusht ka qenë, dhe pastaj dy ditë janë lëshuar ato fontana, e kam postimin në facebook, pra nuk janë mirëmbajtur dhe as nuk kanë punuar ato fontana, pra vetëm dy ditë janë lëshuar në funksion dy fontanat në shesh në afërsi të katër Dëshmorëve dhe një këtu afër që është në formë të tushit, te lumi Llap. Pra aty ishte pagesë 1000€ dhe unë e potencova që ajo pagesë është dedikuar për këtu në shesh dhe nuk ka pasë mirëmbajtje si dhe nuk kanë funksionuar ato fontana, madje as në vapën më të madhe kur ka qenë, këtë e din edhe ti mirë i nderuar drejtor sikurse që e di edhe unë, nuk po ta them në aspektin politik sepse sa është Podujeva e imja është edhe e juaja, mirëpo ne duam sqarime për pagesa se për çfarë janë bërë sepse e dim që bëhen këto pagesa siç ishte edhe pagesa që nuk e përmenda ku disa herë e ke qitë për ta bërë projektin për zgjerim të lumenjve, pra ke sërish një pagesë ashtu, pastaj ishte edhe mirëmbajtja e lumenjve, dhe pastaj po grumbullohen ato. Unë nuk po e them që veç te ne nuk i ke mirëmbajtur, ne e dim çfarë problemi është me lumenj, kush i ka afër ato e din këtë se kur ka vërshime rritet uji dhe hyn nëpër oborre, kur është vlera duhet me dal me “gazmaskë” prej kundërmimeve.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i DSHPMSH, theksoi, tani parafolësi e zgjeroj paksa temën, u tha që nuk janë lëshuar kurrë fontanat në shesh e pastaj u tha që janë lëshuar nja 2 ditë, unë po e kuptoj që ke pasiguri në këtë sepse ato fontana janë lëshuar më shpesh. Sa i përket mirëmbajtjes për të cilën po ashtu e potencoj parafolësi se nuk janë ndërruar kurrë gypat, madje e përmendi një për të cilin e the që rrjedh vazhdimisht, fakt ashtu është sepse për me rrjedhë ujë është ai gyp për t'a ujit drurin kurse në stinën e dimrit nuk rrjedh sepse ndalet i gjithë sistemi i ujitjes, mirëpo sa i përket sistemit

të ujitjes vetëm edhe një çështje e kam, nuk është mirë të fokusoheni vetëm në ato që i shihni, por të fokusoheni në ato që i shihni e që nuk po i përmendni, përndryshe qysh do të funksiononte sheshi i qytetit, parqet, gjelbërimi e të tjera, pa sistem të ujitjes, më tregoni a do të kishte ndonjë mundësi në rast se nuk funksionon sistemi i ujitjes te ujitja e parqeve, ato parqe të jenë të gjelbërta gjatë gjithë verës që kanë qenë qysh ka mundësi kjo, andaj nuk po e zgjati më shumë rreth kësaj sepse i tëri është sistem i ujitjes që është nën tokë dhe që rrjedhin ujë duke e ujitur barin, nuk është vetëm fontana ose veç drunjtë, sistemi i ujitjes është pak më i gjerë.

Sa i përket çështjes së lumenjve që po ashtu e zgjeroi paksa parafolësi, unë disa herë e kam treguar këtu në Kuvend që përveç kontratës së rregullimit të shtretërve të lumenjve, në çdo vit obligohemi të bëjmë kontratë edhe për mirëmbajtjen e lumenjve, pra këto janë kontrata të ndryshme dhe dallojnë sepse janë dy kontrata në vete, mirëmbajtja paguhet prej mallra dhe shërbime, ndërsa kjo e rregullimit paguhet prej investimeve kapitale. Në një kohë nuk guxojmë të rrimë pa kontratë për mirëmbajtjen e lumenjve sepse ndodhin shumë raste e që u përmend se nuk janë lumenjtë mirë dhe unë pajtohem në këtë, mirëpo kjo është ideja që ne kemi dashtë bëjmë projekt për rregullim të tërësishëm të shtretërve të lumenjve sepse nuk mbahet lumi dhe nuk rregullohet me mirëmbajtje por pastrohen në raste të caktuara kur ka bllokime, hapen ndokund, largohet ndonjë mbeturinë ose ndonjë dru kur ka raste të bien në lum, pra është kosto e vogël dhe paguhet prej kategorisë mallra dhe shërbime, ndërsa çështja e rregullimit të shtretërve unë sërish shumë mirë ndihem kur e di që jemi në një proces kur do t'i rregullojmë lumenjtë në tërësi 100 km e që është një prej projekteve më të rëndësishme dhe që besoj se në të ardhmen pas këtij projekti nuk do të keni çka diskutoni më lumenj përveç fjalëve të mira sepse është një kosto e lartë dhe kjo është bërë falë mbështetjes së Ministrisë së Mjedisit sepse përndryshe si Komunë ka qenë e pamundur ta bëjmë një rregullim dhe ndërtim të këtyre shtretërve, pra veç t'i kemi të qarta dhe t'i dallojmë mirëmbajtjen dhe ndërtimin, mallra dhe shërbime, investime kapitale sepse po ndodh që këtu po i ngatërroni dhe po i cekni e që po zgjeron temat pa nevojë ndoshta, por si do që të jetë ne jemi këtu për të diskutuar.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ju rikujtoj se në bazë të rregullores së punës, 3 minuta është e drejta ndaj replikës dhe 2 minuta të jepet përgjigje, andaj ju lutem t'i përmbahemi Rregullores.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, drejtori parafolës i DSHPMSH na u drejtua duke na thënë, po folni çka shihni e jo çka nuk shihni, unë them se për çka nuk shihet është "Baba Vanga", andaj unë veç çka shohë foli sepse çka nuk shohë kurrë nuk foli.

Sa i përket asaj që e tha për rregullimin e lumenjve, të kam thënë edhe njëherë dhe sërish po ta them, as nuk pyes partinë as askënd, kurdo silleni çfarëdo projekti për kanalizime dhe për rregullime të lumenjve votën time e ke nga ky vend ku jam dhe madje e mbaj dorën e ngritur goxha gjatë dhe me krenari bile sepse është për të mirën tonë për gjithë qytetarët.

Kur e përmende i nderuar drejtor çështjen e ujitjes, po e ngatërron paksa sepse sistemi i ujitjes unë e di kah është, kurse ti po do të thuash tani edhe kur e kanë larë qytetin kanë shkuar me cisternë dhe e kanë ujitë por nuk i bie ajo ashtu, sistemi i ujitjes unë i kam shikuar dy-tri herë kush i ka marrë kontratat dhe e di shumë mirë çka ka bërë, prandaj nuk është ashtu qysh po thua ti drejtor, unë po foli pa politikë e ti qysh dush kuptoje ose përgjigju, nuk ka problem.

znj.Valbona Ibishi-Azemi, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS, theksoi, lidhur me kërkesën / pyetjen që u parashtrua për z.Shqipdon Rushiti, po besoj që është organizmi i fundit që ka ndodh në muajin janar "Trinomi i Janarit" në të cilin ke qenë prezent edhe ti i nderuar zotëri Rrahmani, andaj vetëm po ju ri informoj për këtë sepse informimin për këtë jua ka dhënë edhe z.Fatri Zhitija në mbledhjen e kaluar, pra është e njëjta kërkesë për të cilën po kërkohet sqarim, mirëpo për të gjitha dokumentacionet dhe çështje tjera mund të vini edhe në zyrë por mund t'jua dërgoj edhe përmes e-mailit ose çfarëdo që dëshiron, nuk është fare problem kjo.

Prandaj te pyetja pse i janë dhënë 3000€ z.Shqipdon Rushiti, është për manifestimin që është organizuar më 31 janar në Teatrin e Qytetit ku ke qenë prezent edhe ti Ekrem që ka qenë manifestimi “Trinomi i Janarit”.

z.Ekrem Rrahmani, nga vendi duke i reaguuar drejtoreshës, thekson, për atë ju njëherë e keni publikuar që atë organizim e ka bërë Ministria, andaj unë vetëm pyeta dhe kërkova sqarim pse 3000€ atij personi.

znj.Valbona Ibishi-Azemi, U.D. drejtoresh e DKRS, vazhdoi, nuk është publikuar që atë organizim e ka bërë Ministria. Kryeministri ka dhënë mbështetje për vitin e ardhshëm që do të jetë vit jubilar, pra nuk ka thënë se është bërë për këtë vit por për vitin e ardhshëm i cili ka dhënë mbështetje duke premtuar se do të ndahet mbështetje financiare nga Kryeministria dhe nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

z.Ermal Osmani, theksoi, dua të ndërlihem me drejtorin z.Bahri Selimi i cili na u drejtua, a jeni duke i parë parqet me plotë gjelbërim, por unë dua t’i them drejtorit sepse i bie nganjëherë të kaloj nga rruga “Ali Ajeti” afër hekurudhës, dhe e ka parë parkun aty në çfarë gjendje është e që e dim se në muajt korrik dhe gusht ai bari aty thahet komplet, nuk mirëmbahet, pastaj i kemi edhe dy parqe të vogla të cilat i kemi ndërtuar ne por që nuk i keni mirëmbajtur, njëri te shtëpia e ish kandidatit të LVV-së për Deputet z.Hamdi Jaha, më saktësisht ndoshta po e dini ju se ku është si dhe tjetri është te Oda e Katundit në fshatin Sfeçël, e të cilët janë në gjendje të mjerueshme.

Sa i përket mirëmbajtjes së sistemit të ujitjes, e din këtë çështje të tjerët sepse kanë qenë ish drejtor në të kaluarën, ai sistemi që e keni montuar aty është 0.5 cent n’metër, ndarja është me gyp 3/4 dhe ai 30 cent, që do të thotë se një kosto aq e madhe nuk po më duket e arsyeshme.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i DSHPMSH, theksoi, këtë që e përmendi parafolësi nuk është në kuadër të temës që ishim duke diskutuar, do të thotë nuk ka të bëjë kjo çështje me sistem të ujitjes sepse nuk kanë sistem të ujitjes ato. Fjala ishte për parqet që janë në sheshin e qytetit që kanë sistem të ujitjes, jo për ato që nuk kanë, e ai park që e ceke nuk ka sistem të ujitjes, as ai te ish kandidati i Listës Guxo që u përmend, nuk sistem të ujitjes sikurse që nuk ka as ai te Oda e fshatit Sfeçël, mirëpo mirëmbajtja hynë te kjo. Krejt ai diskutim ishte për 190 euro.

z.Enis Dervisholli, theksoi, i nderuar drejtor i DSHPMSH, a ka mundësi në atë çmim që nuk qenka aq i lartë, ta bëni sistemin e ujitjes edhe në rrugën për Shtedim sepse ka shumë drunj/pemë dekorativ por që nuk kanë sistem të ujitjes, andaj a ka mundësi t’iu bëhet edhe atyre ai sistem sepse ato nuk kanë sistem dhe nuk ka pas planifikim.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i DSHPMSH, theksoi, tani këtu nuk kemi të bëjmë me mirëmbajtje më, por kemi të bëjmë me rregullim dhe zgjerim të sistemit të ujitjes që do ta marrim dhe do ta trajtojmë si mundësi edhe pse është vështirë e realizueshme sepse mungojnë puset/bunarët, e them këtë sepse kemi tentuar shumë herë që t’ju bëjmë sistem të ujitjes gjithë drunjëve dekorativë që janë skaj rrugëve por nuk kemi mundur sepse mungojnë puset, mungon uji, andaj pa pasë ujë të siguruar nuk kemi kurrfarë leverdie të ndërtojmë sistem të ujitjes.

znj.Arbnorë Uka-Osmani, U.D. drejtoresh e DBF, theksoi, sa i përket komenteve për 300 pjesëmarrës në darkën e fund vitit, atëherë dua të jap edhe një sqarim shtesë që aty kanë qenë të përfshirë, përveç punëtorëve të Komunës. Stafi i Teatrit dhe zyrtarët e Brigadës së Zjarrfikësve.

Po ashtu edhe një sqarim tjetër është se përveç që ne bëjmë një parapagim të qirasë siç e dim ne për ata që janë ekonomistë në këtë rast, ndërsa ata që nuk janë ekonomistë po e sqaroj se ne vejmë parapagime vetëm për qira ndërsa shpenzimet tjera normale që i përkasin vitit 2025 sepse njëherë bëhet investimi, pastaj furnizimi e mandej bëhet pagesa, pra kjo ishte vetëm sa për sqarimin e juaj.

z.Isak Ejupi, theksoi, po thujse e kaluam raportin financiar tremujor, por megjithatë një kategori për të cilën nuk është dhënë asnjë sqarim e që unë kam nevojë të më jepen dy sqarime është furnizimi me lëndë djegëse në tremujorin e parë të këtij viti, atëherë pse në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar nuk ka pasë investim në këtë kategori kurse tjetra si është e mundur që lëndë djegëse të shpërndahen nëpër shkolla në këtë periudhë kur faktikisht duhet të shpërndahen në tremujorin e fundit kalendarik. Do të thotë është paksa e paarsyeshme dhe kërkoj një sqarim rreth kësaj çështje.

znj.Arbnorë Uka-Osmeni, U.D. drejtoresh e DBF, theksoi, sa i përket furnizimeve, këto kanë ndodhur në fund të vitit 2025 dhe në janarin e vitit 2026 kurse pagesat janë bërë janë bërë tani për ato furnizime. Kurse sa i përket pyetjes tjetër të parafolësit pse ka qenë pagesa në këtë vit dhe në krahasim me vitin e kaluar, kjo do të thotë veç se në vitin e kaluar pagesat janë bërë me kohë sepse ka pasë mjete buxhetore, kurse në këtë rast në vitin 2025 nuk ka pasë buxhet dhe ato kanë mbetur si obligime të papaguara.

z.Isak Ejupi, theksoi, e nderuar drejtoresh unë mendoj se lidhur me këtë sigurisht ka të bëjë me ciklin e zgjedhjeve që kanë ndodh në vitin e kaluar. Do të thotë është investuar diku kur është dashtë kurse tani mbetemi pa buxhet, por si do qoftë ju falënderoj për sqarime.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, e konsideroj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës dhe kalojmë në të radhës.

Konstatohet e përfunduar kjo pikë e rendit të ditës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, nëse e përkrahni të gjithë propozoj të shkojmë në pauzë sepse në vazhdim kemi edhe 3-4 pika mjaft të rëndësishme që t'i shqyrtojmë, andaj mund të shkojmë në pauzë për rreth 1 orë dhe pastaj kthehemi e vazhdojmë më të freskët. Kjo vetëm nëse mbështete nga të gjithë ose shumica, qoftë edhe me vota.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë ju pyes apo e hedh në votim propozimin për pauzë për rreth 1 orë, por megjithatë unë sapo u njoftova nga Kryetari por edhe nga ueb faqja e Komunës që është një ceremoni e lansimit te objekti i galerisë në ora 12:00, projekti i Wi-Fi - internet falas për qytetarët e Podujevës, andaj kush do që dëshiron mund të marr pjesë, andaj nëse pajtohemi mund ta marrim 1 orë pauzë deri në ora 13:00, pra urdhëroni deklarohuni me ngritje dore.

Kryesuesi i Kuvendit Konstatoi se Njëzëri nga të pranishmit sa ishin në sallë, mbështetet që Kuvendi të shkoj në pauzë për 1 orë, (ora 11:40), dhe njëkohësisht caktohet koha e vazhdimit të kësaj seance sot nga ora 13:00.

Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 13:25.

Vazhdimin e mbledhjes e hapi dhe e kryesoi z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit.

Të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV: *Adelinë Stublla; Artrit Mulliqi; Fatri Zhitija; Kasib Bashota; Valdet Kamerolli; Arbrim Konushevc; Luljeta Muçolli-Azemi; Haki Rudari; Abedin Zeka; Qëndresë Hajrizi; Ardi Hasani.* (nuk ishin prezent: Florent Hasani; Flandra Kadriu; Vlora Jashanica; Avni Islami)

Nga LDK: *Alisa Jetullahu; Enis Dervisholli; Besim Latifi; Valdet Restelica; Blerta Azemi-Berisha; Valon Demolli; Ekrem Rrahmani; Ermal Osmani; Gresa Qosa-Maqastena; Arben Xhemajli; Arnisa Sylejmani.* (nuk ishin prezent: Enis Shabani; Isak Ejupi)

Nga PDK: *Isak Shabani-Kryesues i Kuvendit; Lulzim Pollomi; Mimoza Abdullahu; Rinesa Goxhufi,*

Nga GUXO: *Demokrat Hodolli,* mungoi.

Nga Unioni i Blakçorve: *Gentrit Arifi.*

Nga AAK: *Baki Feta.*

Gjithashtu të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes nga Ekzekutivi i Komunës ishin, z.Fahri Restelica, Nënkryetar i Komunës, U.D. drejtorët/shat e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Ditjona Statovci-Drejtoria e Administratës DA; Arbnorë Uka Osmani-Drejtoria e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtoria e Arsimit DKA; Lirie Hoti Rama-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Saranda Stublla-Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSH; Shuajb Blakçori-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSH; Behram Latifi-Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE).

Të pranishëm ishin edhe, përfaqësues media lokale (TV Llapi), dhe disa zyrtar komunal.

Kryesuesi i Kuvendit, e hapi vazhdimin e mbledhjes duke konstatuar kuorumin ku prezent në sallë për momentin ishin 29 anëtarë/e të Kuvendit, theksoi, vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës, mirëpo paraprakisht besoj që gjatë pauzës jeni njoftuar se ka ndërruar jetë akademiku Rexhep Qosja, një figurë e njohur Kombëtare e Letërsisë Shqipe, prandaj ju njoftoj për një minutë heshtje në nderim të jetës dhe veprës së Tij me rastin e ndarjes nga jeta.

Mbahet 1 minutë heshtje në nderim të jetës dhe veprës së Rexhep Qosja, me rastin ndarjes nga jeta sot më 23.04.2026

3. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - *Projekti “Furnizim me Mëshqerra”*

znj.Arbnorë Uka-Osmani, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financa-DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, para vetës keni propozim vendimin për shtim të buxhetit dhe kod të ri për projektin furnizim me mëshqerra, ku në vlerë totale projekti është 428,004.00€, ndërsa participimi i qytetarëve është 30% apo 128,401.002€, ndërsa 70% pjesa e vlerës së Komunës 299,602,008€, andaj pres nga ana e juaj që ta përkrahni këtë shtim të buxhetit dhe kod të ri.

z.Ardi Hasani, theksoi, në emër të Grupit të LVV e përkrahim propozim vendimin për shtim të buxhetit dhe kod të ri në projektin furnizim me mëshqerra.

z.Arben Xhemajli, theksoi, ne Grupi i LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri në projektin furnizim me mëshqerra, ndonëse kemi diskutuar si Grup se Kuvendi nuk është kompetent për shtimin e kodeve të reja pasi kjo është kompetencë e Ministrisë së Financave, mirëpo sidoqoftë ne e përkrahim këtë propozim vendim.

znj.Rinesa Goxhufi, theksoi, edhe ne Grupi i PDK-së e përkrahim këtë propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri në projektin për mëshqerra.

z.Enis Dervisholli, theksoi, sot po diskutojmë për një pikë mjaftë të rëndësishme të rendit të ditës, ku diçka nuk është duke shkuar mirë me mëshqerra ku çmimi i një mëshqerre të deklaruar në Doganën e Kosovës në tremujorin e parë 2026 është 1126€, ndërsa Komuna ka lidhur kontratë me çmim 2642€ ku sipas kontratës mëshqerrat duhet të jenë 2 deri në 3 vjeçare ndërsa ju keni shpërndarë mëshqerra 5 vjeçare e sipër,. E them këtë sepse kam informata se disa fermer kanë kryer pagesë dhe nuk kanë pranuar t'i marrin ato mëshqerra për shkak të vjetërsisë së tyre, andaj do të doja që të dëgjoja arsyetimin e Drejtorisë për këtë çështje sepse ka shumë fermerë që nuk i kanë pranuar mëshqerrat për shkak të vjetërsisë së tyre.

Përveç kësaj kam edhe një kërkesë lidhur me mungesën e zyrës për këshillimin e fermerëve, pse Komuna jon nuk disponon një zyre për këshillimin e fermerëve kur edhe dihet që Komuna jon është ndër 5 komunat e vetme në Kosovë që nuk e posedon këtë zyre dhe mungesa e kësaj zyre është duke e dëmtuar drejtpërdrejtë fermerin, veçanërisht në përgatitjen e aplikacioneve për grante dhe subvencion. A ekziston mundësia që mosfunksionimi i kësaj zyre të jetë duke u shfrytëzuar nga individ të caktuar duke krijuar hapësirë për përfitime të padrejta përmes ofrimit të këshillave jashtë institucionit të Komunës, prandaj kërkoj nga Ekzekutivi i Komunës sqarim se pse ende nuk është themeluar kjo zyrë, pastaj afatin kohor se kur planifikohet themelimi i saj, në mënyrë që fermerët të kenë mbështetje të drejtë profesionale dhe transparente.

z.Behram Latifi, U.D. drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR, theksoi, lidhur me pyetjen që e bëri parafolësi anëtar i Kuvendit, nuk është që fermerët kanë refuzuar që t'i marrin mëshqerrat, është e vërtetë që disa mëshqerra janë refuzuar nga komisioni për shkak se nuk i kanë përmbushur kriteret e parapara me kontratë. Nëse keni ndonjë pyetje shtesë urdhëroni mund t'ju jap përgjigje apo sqarimet e nevojshme.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, e potencova edhe dje në mbledhjen e KPF-së ku më shumë më shqetësoi rasti se pse kontrata është lidhur në nëntor të vitit të kaluar, pse atëherë nuk janë ndarë mjetet dhe qysh është lidhë kontrata pa zotim të mjeteve, kurse tani pasi është lidhur kontrata fermerët i kanë dhënë parat për participim dhe tani po ashtu të shtohet kodi i ri. Për këtë mund të them se është keq klasifikim dhe keq planifikim, ose ndryshe nëse janë ndarë mjetet për atë dhe ka ndryshuar dhe këto mjete kanë shkuar në një vend tjetër është dashtë që drejtoresha e DBPZHR të na jap një sqarim. Ndërsa edhe te përgjigja e drejtorit parafolës, kolegu z.Enis Dervisholli e bëri edhe një pyetje tjetër e që drejtori nuk u përgjigj sa i përket zyrës këshilluese që është obligim, dhe është e vërtetë që janë vetëm 5 komuna si Hani i Elezit, Parteshi, Podujeva, Skenderaj, Zveqani të vetmet që nuk janë funksionalizuar zyrat këshilluese informuese për fermerët.

znj.Arbnorë Uka-Osmani, U.D. drejtoresh e DBF, theksoi, edhe dje e kemi diskutuar te zotimi i mjeteve se çdo procedurë e prokurimit iniciohet nga fillimi deri në fund bazuar në ligjet që i kemi në fuqi. Vitin e kaluar kjo procedurë është iniciuar në muajin prill edhe kanë qenë mjete të zotuar për këto dy projekte, mirëpo për shkak të vonesave deri në nënshkrimin e kontratës të cilat janë nënshkruar në muajin dhjetor 2025, nuk është arritur që projekti të finalizohet për shkak të afatit shumë të shkurtër. Ndërsa sa i përket shtimit të kodit të buxhetit, edhe pse në parim ju e përkrahët këtë shtim të kodit, vetëm sa për sqarim edhe për qytetarët në këtë rast, shtimi i kodit të buxhetit dhe shtimi i buxhetit realizohet përmes Thesarit dhe ata nuk e shtojnë kodin e buxhetit e as

buxhetin pa pasur vendim të Kuvendit të Komunës, e në këtë rast participimin e Komunës së Podujevës e kemi në kuadër të buxhetit për vitin 2026, ndërsa donacionin e brendshëm në këtë rast financimin nga qytetarët nuk kemi mundësi ta shtojmë pa vendim të Kuvendit për shkak se refuzohet si kërkesë e tillë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendi tët ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë propozim vendim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 28 vota Për nga anëtarët/et e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - Projekti “Furnizim me Mëshqerra”, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

4. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - Projekti “Furnizimi dhe Montimi i Serrave”

znj.Arbnorë Uka-Osmani, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financa-DBF, e paraqiti fjalën hyrëse edhe rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, pra e kemi edhe propozimin vendimin për shtim të buxhetit dhe kod të ri në projektin furnizimi dhe montimi i serrave në vlerë të përgjithshme 324,862.90€, participimi i qytetarëve është në vlerë prej 30% ku në vlerë monetare është 97,458.87€, ndërsa pjesa tjetër është financim nga Komuna e Podujevës, andaj pres nga ju që të përkrahni këtë pikë të rendit të ditës.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, në emër të Grupit të LVV e përkrahim dhe e mbështetim këtë pikë të rendit të ditës pasi që është në të mirën e qytetarëve dhe fermerëve të Komunës së Podujevës.

z.Ermal Osmani, theksoi, përshëndetje për të gjithë, në emër të Grupit të LDK-së e përkrahim propozim vendimin për shtim të buxhetit dhe kod të ri në projektin furnizim dhe montim i serrave.

znj.Mimoza Abdullahu, theksoi, ne Grupi i PDK-së e përkrahim këtë propozim vendim që ka të bëjë me shtim të buxhetit dhe kod të ri në projektin furnizimi dhe montimi i serrave.

z.Enis Dervisholli, theksoi, sa i përket këtij projekti unë e kam një vërejtje, afati i aplikimit është mbyllur më datën 27.11.2025 ndërsa koha në mes afatit të mbylljes dhe shpalljes së fitueseve është 4 muaj, pse Komunës së Podujevës i’u deshën katër muaj për shpalljen e listës së 149 përfitueseve, kjo sepse ndoshta i’u keni premtuar shumë personave dhe nuk keni mundur të bëni seleksionimin adekuat për ta.

Tani duke analizuar kohën, a mos ndoshta është dashtë që serrat të jenë të montuar në këtë kohë, pra përfituesit e këtyre serrave në këtë kohë është dashtë t’i kenë të montuara ato në mënyrë që t’i shfrytëzojnë. Prandaj mendoj që dikush është duke na manipuluar ose mashtruar me çmimet reale sepse sipas çmimeve reale 20% e tregut janë më lirë se sa me kontratën e nënshkruar nga Komuna.

z.Behram Latifi, U.D. drejtor i DBPZHR, theksoi, është e vërtetë që thirrja ka qenë e hapur në vitin e kaluar ndërsa lista përfundimtare ka dal në këtë vit, kjo për arsyeje se me rastin e lidhjes kontratës disa operator ekonomik kanë bërë ankesë në OSHP dhe për këtë arsye është shtyrë afati deri më tani, pra kjo ka ndodhur për shkak që procedura e prokurimit janë vonuar.

z.Enis Dervisholli, theksoi, është e tepërt që 4 muaj të zgjatet dhe të shpallet lista përfundimtare, pra është absurde dhe nuk ka kuptim që të zgjas kaq shumë, a mos keni premtuar shumë dhe tani keni problem mes dy partive që t’i zgjedhni përfituesit, pra është pak e tepërt.

z.Ermal Osmani, theksoi, dua të ndërlihem me drejtorin e DBPZHR sa i përket vonesave të procedurave të prokurimit që kanë zgjatur 4 muaj, pra nuk e pengon me shpall listën e përfitueseve të serrave sepse është krejt komision tjetër që e bënë vlerësimin e tyre.

Ne e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës sepse mund të thoni pastaj që nuk po e përkrahim dhe se është për të mirën e qytetarëve dhe të fermerëve, mirëpo po e theksoj që unë edhe në seancën e kaluar e kam thënë që pagesën jeni duke e bërë të lartë, pra me një çmim jo të tregut por shumë më të lartë se të tregut, si në serra si në kultivator dhe në të gjitha tjerat, si do qoftë ne prap e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës sepse është për të mirën e fermerëve.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, të nderuar koleg vetëm dëshiroj t'ju njoftoj se është paraparë raportimi i Drejtorisë së Bujqësisë në muajin qershor dhe atëherë do të kemi mundësi për çdo gjë që ka nevojë të paraqitni pyetje dhe të kërkonit sqarime dhe raporte lidhur me këto tema, kështu që urdhëroni nëse edhe ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendi të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë propozim vendim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 28 vota Për nga anëtarët/et e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - Projekti "Furnizimi dhe Montimi i Serrave", sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

5. Propozim Programi Trevjeçar i Banimit 2026-2028 në Komunën e Podujevës

znj.Lirie Hoti-Rama, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, fillimisht ju falënderoj për përkrahjen e juaj për vënien në shqyrtim dhe diskutim të pikës të propozuar nga DSHMS lidhur me draft Programin Trevjeçar të Banimit 2026-2028 në Komunën e Podujevës, fillimisht më lejoni të sqaroj se të gjitha procedurat ligjore janë ndjekur lidhur me sjellën në Kuvend të këtij draft Programi, gjithashtu në dosjet e prezantuara para jush e keni të bashkangjitur të gjithë dokumentacionin përkatës lidhur me zhvillimin e të gjitha procedurave dhe hartimin e këtij draft programi, duke filluar me vendimin e formimit të komisionit apo grupit punës për hartimin e programit, po ashtu vendimin për vënie në diskutim publik ku vlen të përmendet që ky draft program ka qëndruar në konsultim publik dhe i publikuar në ueb faqen e Komunës në afat prej 30 ditësh nga data 24 shkurt i këtij viti deri më datën 24 mars, ku gjatë kësaj periudhe 30 ditore me datën 11 mars është mbajtur takimi apo diskutimi publik me qytetar ku të gjitha sugjerimet dhe vërejtjet e dhëna gjatë atij takimi por edhe gjatë kohë kur ky draft program ka qenë në diskutim publik janë marr parasysh të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet të cilat më pas janë shqyrtuar nga grupi punës dhe janë vendosur në draft programin të cilin sot e keni para vetës, dhe këtu vlen të falënderohet edhe kolegu jon nga Kuvendi Komunal z.Ekrem Rrahmani i cili ka dërguar vërejtjet dhe sugjerimet e tij, e që disa prej tyre siç jam informuar me procesverbal nga ana e komisionit janë vendosur edhe në këtë draft që është prezantuar para jush.

Më lejoni që të bëjë një prezantim të shkurtër të këtij draft programi, ky draft program përmban hyrjen, qëllimin, vizionin dhe synimet e tij, objektivat, sfidat, kornizat ligjore në të cilën është bazuar dhe më pastaj profilin e Komunës së Podujevës duke shpjeguar pozitën gjeografike, karakteristikat demografike të saj, projektet për përmirësimin e kushteve të banimit në Komunën e Podujevës, kërkesat faktike për përkrahje kjo duke filluar që nga viti 2022 e deri në fund të vitit 2025, kategoritë e synuara për përkrahje, kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë, planifikimin konkret për banim social, planifikimin buxhetor dhe realizimin e këtij programi duke i

përfshirë të gjitha projektet që kjo fushë i ngërthen në vete, më pastaj përmban analizën e fakteve të përmbledhura, instrumentet mbikëqyrëse të saj, transparenca dhe përfshirja e publikut çështjet e tjera lidhur me temat në diskutim, swot analizën, përfundimin dhe burimin e të dhënave.

Qëllimi i hartimit të Programit Trevjeçar të Banimit në Komunën e Podujevës është identifikim i çështjeve të banimit brenda territorit të saj, duke u bazuar në politikat qendrore dhe të zhvilloj politika adekuate për zgjedhjen e nevojave për banim për grupe të caktuara të cilat nuk kanë mundësi ekonomike dhe sociale për të siguruar banimin e tyre me çmimet e tregut.

Realizimi i këtij programi planifikohet të bëhet përmes fondeve vetanake, investimeve nga niveli qendror, donatorëve të ndryshëm dhe përmes këtij programi tentohet të arrihet përmirësim i vazhdueshëm i kushteve të jetesës për qytetarët e Komunës së Podujevës të cilët kanë nevojë për mbështetje në fushën e banimit. Financimi i këtij Programi është në përputhje me Ligjin nr.03/L-164 për financimin e programeve të veçanta për banimin, dhe njëkohësisht i nënshtrohet zbatimit të metodës së planifikimit strategjik. Vizion dhe qëllim në këtë program është përmirësimi i cilësisë së jetesës për qytetarët si e drejtë e garantuar në çdo kornizë ligjore.

Tek objektivat strategjike të programit, janë në përputhje me kushtet dhe parimet e planifikimit hapësinor të qëndrueshëm. Përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e këtij Programi Trevjeçar të Banimit 2026-2028 janë Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim si dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Tani në Draft Programin e paraqitur para jush siç e përmenda dhe më herët janë të dhënat që nga viti 2022, të cilat e përfshijnë të gjithë fushën e banimit, pra përfshihen qysh nga kërkesa të cilat i ka pranuar DSHMS, kërkesa këto të gjitha të regjistruara e të protokolluara edhe në dosje të veçanta, secila prej tyre gjithashtu edhe me përgjigjet se si është dhënë kahje secilës prej këtyre kërkesave por edhe statusi i tyre qysh qëndrojnë deri më sot. Gjithashtu edhe të gjitha projektet që janë zhvilluar sa i përket fushës së banimit qysh nga viti 2022, mirëpo për shkak që mos t'ju marr më shumë kohë, unë sot por dua që të ndalem të projektet të cilat i kemi në ecuri tani dhe të cilat me këtë program trevjeçar planifikohet dhe janë objektiv që të arrihen në realizim, pra në këtë Program Trevjeçar të Banimit, dua të ndalem që në vitin 2024 Komuna e Podujevës e ka nënshkruar Marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit të Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për projektin e banimit të përballueshëm që është një prej projekteve më të rëndësishme që po zhvillohet dhe realizohet në fushën e banimit. Ky projekt ka filluar të realizohet ku përfshihet ndërtimi i njërive të reja të banimit në zonën e ish tregut, ky kompleks do të ketë gjithsej 133 njësi të banimit të cilat do të ndahen në këtë mënyrë, ku 106 prej tyre do të jenë për banim ndërsa për banim social do të jenë 27 prej këtyre banesave. Kur them 106 këto janë për çiftet e reja siç e keni parë dhe keni dëgjuar edhe në media, ndërsa ende nuk është publikuar ftesa për aplikim e cila do të publikohet pas miratimit edhe në Kuvend të projektligjit ku i përcakton kriteret.

Gjatë vitit 2024 po ashtu Komuna e Podujevës ka filluar ndërtimin e Qendrës Rezidenciale për të Moshuar në bashkëfinancim mes Shoqatës “Jetimat e Ballkanit” projekt ky i cili tashmë është në fazën e inventarizimit dhe shumë shpejt do të bëhet edhe hapja e kësaj Residence.

Në vitin 2025 Komuna e Podujevës po ashtu ka nënshkruar Memorandum të Mirëkuptimit me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit” për ndërtimin e 5 shtëpive me participim të Komunës për familjet në nevojë, ku deri më tani janë ndërtuar 3 shtëpi dhe tashmë janë shpërndarë tek familjet përfituese, ndërsa 2 prej tyre veç kanë filluar dhe janë në procedurë të nisjes së ndërtimit të tyre që i bie se është projekt pothuajse në përfundim dhe realizim.

Një gjë tjetër shumë e rëndësishme që është përfshirë në këtë draft Program Trevjeçar të Banimit, përveç banimit të përballueshëm Komuna e Podujevës është përfituese edhe një projekti në

bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes së Mjedisit, pra është banimi adekuat social i cili prapë parasheh 3 nën projekte të saja, e ku Komuna e Podujevës është përfituese dhe tash është në fazën e realizimit të projektit, e ky projekt përbëhet prej ndërtimit të njërive të reja të banimit ku gjithsej parashihet të ndërtohen 20 njësi të banimit, pra 20 familje përfituese, rindërtimi i 10 shtëpive dhe renovimi i 40 shtëpive për rastet sociale dhe familjet me të hyra të ulëta. Te ky projekt veç jemi në fazën e realizimit të tij sa i përket dy nënprojekteve renovimit dhe rindërtimit të shtëpive, tashmë jemi në fazën e përzgjedhjes së familjeve përfituese, mirëpo vlen të cekët që jemi duke pasur një sfidë jashtëzakonisht të madhe në plotësimin e dokumentacionit për shkak se njëra prej kërkesave të Ministrisë ka qenë që pronat të jenë në emër të përfitueseve, pra kjo është një sfidë mirëpo në bashkëpunim me Ministrin jemi duke u munduar t'ju japim ndihmë të gjitha familjeve që janë përfituese të këtij projekti.

Gjithashtu për fund dhe nuk dua ta zgjas më shumë, vlen të përmendet që programi i prezantuar para jush ka këto objektiva, implementimin projektit për banim të përbalueshëm i cili është duke u realizuar dhe objektivi ynë është që të përfundoj në kohëzgjatje prej tri vite që tash më është veç në realizim, implementimi i projektit për banim social adekuat për Komunën e Podujevës që i përfshin tri nënprojekte të cilat tashmë veç i përmenda, hapja e Qendrës Rezidenciale për të Moshuar projekt i cili është në bashkëfinancim me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit”, vazhdimi i ndërtimit të shtëpive për familje sociale në bashkëfinancim me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit” dhe donator të tjerë ku vlen të cekët se në program nuk është e përmendur për shkak që ky veç ka qenë e përfunduar dhe tashmë para disa ditësh ne kemi arritur një Marrëveshje me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit” për ndërtimin edhe të pesë shtëpive të tjera në bashkëfinancim me Komunën e që do të realizohen gjatë vitit 2026, tashmë ekipet janë duke punuar në teren për identifikimin dhe përzgjedhjen e rasteve bashkë me anëtarët nga komisioni prej Shoqatës në fjalë.

Verifikimi i banimit dhe vazhdimi i kontratave për 22 familjet në Lagjen “Shqiptarët për Shqiptarët” e ndërtuar në bashkëpunim me Fondacionin Firdues dhe Shqiptarët për Shqiptarët.

Vlerësimin e gjendjes së banimit të familjeve në Lagjen e Dëshmorëve, vizitat dhe vlerësimin e gjendjes tek të gjitha familjet të cilat kërkojnë strehim, ndërtim të shtëpive, riparim apo edhe pagesa për qira, bashkëpunim me donatorë për të bashkëfinancuar projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për qytetarët tanë.

E gjithë kjo është pak a shumë ajo që është e përfshirë në Programin Trevjeçar të Banimit, pra ky është prej programeve më esenciale që kemi të bëjmë sa i përket rregullimit të çështjes së strehimi dhe banimit për qytetarët e Komunës së Podujevës, këto janë veç disa prej projekteve më të rëndësishme që janë të planifikuara për realizim në trevjeçarën e ardhshëm e që janë duke ndodhur edhe tani, kështu që ju ftoj të gjithë juve që duke e pasur parasysh rëndësinë e këtij programi, ta përkrahni dhe po ashtu jam shumë e hapur për gjitha pyetjet edhe vërejtjet që ju mund të keni.

Për fund, ju falënderoj të gjithëve për kontributin që keni dhënë në hartimin e këtij Programi.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, përshëndetje për të gjithë, duke qenë se banimi është një e drejtë universale e garantuar me ligjet e Kosovës dhe me Konventa Ndërkombëtare, dhe duke qenë se nevoja për banim të shumë familje ne Llap është shumë e madhe, në emër të Grupit të LVV e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, edhe ne Grupi i LDK-së në parim e përkrahim, gjatë kohë kur ky draft program ka qenë i publikuar ne ueb faqe unë jam munduar që ta përcjellë, ka pasur edhe dokumente që janë pranuar por i kam pasur edhe disa pyetje që kërkojnë sqarim dhe besoj që drejtoresha parafolëse në këtë rast do të na ndihmoj. Po nisëm nga fjalimi i saj kur e theksoj që duhet shpërndarë edhe unë e kam dëgjuar znj.Fitore Pacolli në Kuvend kur e ka dërguar projekt ligjin e banimit për t'i bërë kriteret dhe si do të ndahen, por gjatë fjalimit drejtoresha e theksoj që

komisioni veç do të filloj t'i ndaj dhe nuk e di se a mundet apo jo deri sa të bëhet ky projekt ligj. Mendoj që kjo pjesë do të na bëjë pak dëme sepse nuk e di sa vonohet ky projekt ligj, por edhe kur janë dy tema banimi social dhe ai përballueshëm, këtu ndoshta te qytetarët nuk po shpjegohen qartë të gjitha, pra te dimë se çka është banimi social dhe ai i përballueshëm sepse te banimi i përballueshëm ka njerëz që jetojnë pak më kallaballëk por kanë shtëpi, tash ne dimë që ndoshta ka kërkesa që nuk dëshirojnë të jetojnë shembull “me vjehërr” dhe i kanë punët mirë por që ka dëshirë të marr një banesë. Këtu duhet të jetë një komision i qartë dhe të bëjë përzgjedhjen sepse unë i kam dyshimet e mia edhe te ato 200 kërkesat që janë bërë për banesa dhe kam frikën që a ka ndonjë familje që ne nuk e dimë dhe nuk i sheh publikimet fare dhe nuk din të bëjë kërkesën fare, pra ne këtu e kemi problemin sepse e dimë që është një dorë që mendojnë se edhe ditën e diel punon Komuna dhe sjellën rreth e rreth Komunës duke bërë kërkesa vazhdimisht e që besoj se më së shumti në telashe prej tyre është edhe vet Ekzekutivi i Komunës.

Përveç kësaj, unë kam hyrë dhe i kam shikuar edhe statistikat dhe më bëri përshtypje shembull në Komunën e Podujevës 70 familje nuk kanë as bojler, unë për këtë arsyeje e kam përcjell dhe kam dhënë komente, andaj jam për të formuar një komision funksional duke shpresuar që i'u ndahen atyre që kanë shumë nevojë, nuk dua të hyj në tjerat statistika sepse edhe ishin edhe disa tjera shumë interesante, ndoshta ne një pjesë që jemi mësuar të bëjmë një jetë pak më të mirë, më bëri përshtypje që ka ende njerëz që pastrohen “me pacërrk”, nuk po e them që është fajtor Komuna por kemi edhe këso raste, prandaj është mirë që ndahen apo shpërndahen këto banesa. Përveç kësaj, e nderuara drejtoresh dua të di se këtë komision a e formon Drejtoria apo Kryetari, dhe gjëja tjetër është të na shpjegosh banimin social dhe atë të përballueshëm.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, vetëm sa për sqarim dua të lexoj Rregulloren e Punës së Kuvendit, ku neni 46 thekson që përfaqësuesit e organeve dhe Drejtorive të Administratës Publike të Komunës, përkatësisht propozuesve të materialeve dhe çështjeve të shtruarra gjatë debatit, sqarimet plotësuese i paraqesin pas përfundimit të diskutimit të të gjithë të paraqiturve në diskutim, pra e nderuar Drejtoresh mund t'i evidentosh dhe në fund e merr fjalën dhe i sqaroni.

z.Lulzim Pollomi, theksoi, Programi Trevjeçar i Banimi 2026-2028, që kemi sot para nesh është një hap shumë i rëndësishëm drejt adresimit të një problemi të kamotshëm në Komunën tonë, dhe në emër të Grupit të PDK-së shprehim mbështetjen tonë për këtë program duke konsideruar si një bazë të mirë për veprim, megjithatë ajo që bën dallimin nuk është përmbajtja e dokumentit por është cilësia e zbatimit të tij, prandaj ne si Grup i PDK-së vlerësojmë se ky program duhet të shoqërohet me disa elemente kyçe. Si element i parë, duhet të jetë një plan i detajuar financiar që garanton që projektet e parapara nuk mbesin vetëm ideja por marrin mbështetje reale buxhetore. Së dyti, është e domosdoshme që Komuna të jetë proaktive në sigurimin e partneriteteve mes Qeverisë qendrore dhe donatorëve ndërkombëtarë në mënyrë që të rritet kapaciteti investues në këtë sektor. Së treti, po ashtu që është shumë i rëndësishëm duhet të sigurohet një mekanizëm i besueshëm dhe transparent i përzgjedhjes së përfitueseve që bazohen në kritere të qarta dhe të matshme duke shmangur çdo dyshim për padrejtësi.

Ne gjithashtu vlerësojmë hapat e deritanishëm që janë ndërmarr në këtë drejtim por duhet të jemi të vetëdijshëm se nevojat janë shumë më të mëdha se ajo që është bërë deri më tani. Kjo na obligon që të punojmë edhe më shumë dhe më mirë në vitet në vijim.

Një dimension shumë i rëndësishëm i këtij programi është edhe përfshirja e kategorive të ndryshme dhe kategorive më të ndjeshme sociale, në mënyrë të veçantë kategoritë e dala nga lufta, kategoritë me asistencë sociale, personat me aftësi të kufizuara dhe nënat kryefamiljare.

Të nderuar koleg, praktikant ndërkombëtarë na tregojnë që politikat e suksesshme të banimi ndërtohen mbi transparencë dhe qëndrueshmëri dhe këto parime duhet t'i ndjekim edhe ne, në këtë

frymë ne do ta mbështesim këtë program duke kërkuar njëkohësisht që të krijohet një mekanizëm i rregullt raportimi para Kuvendit në mënyrë që të monitorohet procesi dhe të sigurohet llogaridhënia sepse përgjegjësia jon nuk përfundon këtu, por përfundon me miratimin e dokumenteve dhe me zbatimin e tyre në praktikë.

znj.Lirie Hoti-Rama, U.D. drejtoreshë e DSHMS, theksoi, atëherë po filloj me kolegun z.Ekrem Rrahmani që t'i jap disa sqarime, te banimi i përballueshëm komisioni është në teren lidhur me vlerësimin e shtëpive me Marrëveshjen të cilën e kemi me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit” dhe jo me banimin e përballueshëm. Lidhur me shpërndarjen e njësive banesore tek projekti i banimit të përballueshëm, ende nuk është formuar komision për shkak se ende nuk është hapur ftesa publike sepse nuk janë caktuar kriteret që duhet të përmbajë kjo ftesë. Mandej sa i përket banimit të përballueshëm dhe social adekuat, është e vërtetë që te projekti i banimit të përballueshëm janë dy ndarje apo dy grupe të dhurimit të njësive banesore ku 106 janë banim i përballueshëm, ndërsa 27 janë banim social. Sqarimin që mund të jap sot është ky, te banimi i përballueshëm nënkupton jo domosdoshmërisht familjet që marrin asistencë sociale apo janë në kushte shumë të rënda, ku edhe për këtë është referuar që i'u jepet çifteve të reja, pra janë familjet të cilat marrin ndoshta një pagë nën mesataren dhe kjo është me qëllim që t'ju lehtësohet dhe t'ju ndihmohet atyre në kushtet e jetesës. Ndërsa banimi social është i krijuar në atë mendim që t'ju ndihmohet vetëm familjeve që janë raste me asistencë sociale dhe me kushte shumë të rënda ekonomike. Pra ky është një sqarim lidhur me këtë çështje, mirëpo nëse ka nevojë për sqarim shtesë ne mund t'iu referohemi edhe me e-mail duke ju përcjell dokumente tjera shtesë. Për atë arsyeje pastaj i kemi dy projekte, është banimi adekuat social ku aty do të jepen njësi banesore vetëm për familjet me raste të asistencës sociale dhe me kushte të rënda ekonomike.

Lidhur me kërkesat të cilat janë dorëzuar është e vërtetë se njëra prej diskutimeve apo sugjerimeve që z.Ekrem Rrahmani i ka përcjellë kur ky dokument ka qenë konsultim publik, ka qenë shembull kjo diferenca e madhe po themi në mes vitit 2024 dhe vitit 2025 të kërkesave të dorëzuara në DSHMS sa i përket strehimit dhe banimit, dhe pse shembull ka ndryshuar ky numër nga vitit 2024 që ka qenë numër më i ulët kurse në vitin 2025 është më i lartë. Ftesa kur është bërë dhe kur është publikuar ajo shumica e qytetarëve e kanë keqkuptuar atë sepse kanë menduar se kjo nuk është për rindërtim dhe për renovim të shtëpive, por shembull edhe për fasada dhe çështje tjera të ngjashme të kësaj natyre, dhe për atë arsye numri i kërkesave është ngritur jashtëzakonisht shumë i rasteve aplikuese, mirëpo jo domosdoshmërisht këto familje kanë qenë me kushte të rënda ekonomike apo me asistencë sociale, por pas verifikimeve dhe shqyrtimeve nga na e komisionit janë kthyer përgjigjet e nevojshme dhe mandej është përzgjedhë vetëm lista e ngushtë të cilët i kanë plotësuar kriteret sipas ftesës publike por edhe sipas kriterëve që i përmban projekti.

Sa i përket formimit të komisionit, pra e sqarova më parë se te banimi i përballueshëm nuk është krijuar ende komision por në momentin që krijohet ai komision sigurisht se do të jetë publik dhe do të publikohet edhe në ueb faqen e Komunës.

z.Fatri Zhitija, theksoi, falënderoj drejtoreshën parafolëse të DSHMS sepse në mënyrë shumë të mirë e sqaroi çështjen e projektit të banimit të përballueshëm dhe social. Meqë tani jam edhe në një angazhim të ri atje në Ministrinë e Mjedisit dhe jam i përfshirë në këtë projektin e banimit të përballueshëm dhe social, dëshiroj t'i ndaj disa detaje. Te çështja e banimit të përballueshëm për familjet përfituese shpërndarjen / përzgjedhjen e bënë Ministria kurse te banimi social për familjet përfituese shpërndarjen / përzgjedhjen e bënë Komuna për shkak se i posedon listat e familjeve që marrin asistencë sociale.

Sot është miratuar projektligji në lexim të dytë dhe prej sot hynë në fuqi ky projektligj, dhe meqë sot ka kaluar në Kuvend të Kosovës dhe që ka kaluar gjitha procedurat ligjore për të filluar me zbatimin e tij.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse edhe ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendi tët ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë propozim Program Trevjeçar të Banimit sipas materialit përkatës të dërguar me Konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 22.04.2026.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 27 vota Për nga anëtarët/et e Kuvendit që ishin prezent në sallë, me vendim miratohet propozim Programi Trevjeçar i Banimit 2026-2028 në Komunën e Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me Konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 22.04.2026,

6. Të ndryshme

z.Haki Rudari, theksoi, natyrisht se po ka kërkesa të shumta nga kolegët lidhur me vonesat nëpër seanca si pasojë e parkingut apo mungesës së parkingut. Ne si Kuvend i Komunës e kemi themeluar një Ndërmarrje Komunale dhe konsideroj se ky Kuvend është mirë të merr një vendim nëse veç është e nevojshme që anëtarët e Kuvendit kur kanë seanca, kur ka angazhime zyrtare në Komunë, të lirohen nga parkingu apo pagesa dhe ajo mund të realizohet në dy mënyra, fillimisht Drejtoria e Administratës mund ta dorëzoj listën atje nëse nuk e kanë, por menjëherë t'i filloj edhe krijimi apo marrja e bexhave identifikues ose të filloj me pajisjen e anëtarëve të Kuvendit me bexha identifikues e që konsideroj se është në interes të të gjithë qytetarëve pa dallime, dhe mendoj që nuk është në rregull që anëtarët e Kuvendit të Komunës të enden poshtë e përpjetë si pasojë e mungesës së parkingut, prandaj është mirë që ne si Kuvend i Komunës së Podujevës të marrim një vendim jo politik në këtë rast.

znj.Gresa Qosa-Maqastena, theksoi, mund të vazhdojmë njëherë me pyetjet që kanë qenë nga seanca e kaluar e mandej të fillojmë me pyetjet për seancën e sotme, e them këtë meqë kemi parashtruar pyetje në atë seancë dhe nuk kemi marrë përgjigje në seancën e kaluar, konkretisht unë për një pyetje që kam pasë për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit e që besoj se i kujtohet drejtorit.

z.Ermal Osmani, theksoi, sa i përket kolegut parafolës z.Haki Rudari edhe ne e përkrahim këtë nismë dhe mendoj se është në interesin e asambleistëve të Kuvendit të Komunës së Podujevës, prandaj si Grupi i LDK-së e përkrahim.

z.Lulzim Pollomi, theksoi, sot dëshiroj të ngrisë një shqetësim shumë të rëndësishëm në këtë Kuvend, që ka të bëjë me mungesën e ujit të pijshëm në fshatin Lladoc, konkretisht nga shkolla e fshatit “Ali Ajeti” lartë pothuajse se ka shtatë muaj që nuk ka fare furnizim me ujë, dhe është e papranueshme që në vitin 2026 qytetarët të përballen me mungesë të ujit për një periudhë kaq të gjatë duke ditë se uji është një nevojë elementare dhe jetike për çdo banorë, andaj mungesa e tij ndikon drejtpërdrejtë në jetën e përditshme të qytetarëve, prandaj kërkoj nga organet përgjegjëse dhe Drejtoria përkatëse që të ndërmarrin hapa urgjent dhe konkret për zgjidhjen e këtij problemi sa më parë që të jetë e mundur në atë pjesë të fshatit Lladoc.

z.Valon Demolli, theksoi, deshta të marrë fjalën sepse i kam mbet borxh drejtorit (të DKA) në seancën e kaluar. Besoj këtë objekt (parqet me foto një objekt në qytetin e Podujevës) të gjithë e dini ku është dhe i kujt është dhe çka punon pronari i këtij objekti. Ju kujtohet ky objekt që dikur herë i vënit shirit e herë e heqshi, këto kanë qenë ato arsyet për mbylljen e lëndëve dhe për favore i'a kanë liruar atë objekt

kam dëshmi edhe për familjen e tij, edhe në Kaçanik edhe për atje kam informata, dhe krejt çka kam thënë ka qenë e vërtetë dhe asnjë pikë e asnjë presje nuk i'a heq asaj. Pastaj kam informata edhe për shtëpinë në Suboticë të Serbisë. Kam informata edhe qe besa se çka ndodh në Drejtorinë e Arsimit, andaj nuk pres ta pranoj drejtori. E ka pranuar me e-mail zyrtar kur i ka pas punësuar disa militantë t'juaj pa konkurs e qe besa e-mailin zyrtar vetë e ka dërguar dhe e ka pranuar që ka bërë vepër penale që nuk ka zhvilluar procedura të konkursit, andaj ky i ka do dosta të fortë e ata dosta i'a kanë mbyll lëndët.

Mos u çuditni nëse edhe alivanoset sepse ky është mësuar të alivanoset në Prokurori e që si duket edhe ambulanca ka intervenuar sepse ka qenë në gjendje shumë të keqe, nuk e di pse. Qe besa ky edhe 2 banesa i ka bërë në këtë mandat, çudi, dhe unë mendoj se është në top 5-shen e hajnave më të mëdhenj në Komunën e Podujevës. Ky edhe në kohën kur ka qenë në LDK, sistemin pikë pikë, "drejtor shllafi" e ka shpërndarë në garazhet e shtëpisë së vet. E qe besa edhe hoxhë, edhe i pamoralshëm, edhe hoxhë edhe hajn, nuk shkon.

Pastaj e dini një shkollë që e ka pasë ky, e që shteti e ka mbyllë për veprimtari terroriste, ka qenë një shkollë AKE është quajtur. Pra ky është ai drejtori që me ato profilet fake është munduar ta prishë imazhin tim. Për fund, kërkoj falje që paksa hyra në çështje familjare edhe pse nuk është dashtë mirëpo ky ndryshe nuk meriton.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ju lus të gjithëve dhe këtë po e bazoj në nenin 56 të Rregullores ku thuhet se gjatë debatit nuk lejohen shprehje ofenduese, nënçmuese dhe paraqitja e të dhënave nga jeta private e askujt, andaj ju lus të mos ndodh kjo gjë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, kam dy pyetje për drejtorin e DSHPMSh, 1-Nk po e di a po dështon NP KRM "Pastrimit" por ka shumë ankesa dhe më kanë shkruar goxha shumë që po ndodh po bëhen me nga 2-3 javë që nuk po shkojnë të mbledhin mbeturinat, ndërsa ne po e shohim se çka po ndodh kur shportat e mbeturinave po janë pranë shtëpive e që pastaj qentë endacak po i rrëzojnë ato dhe po krijojnë shpërndarje të mbeturinave nëpër rrugë e trotuare, pra po bëhet një lloj hallakame në këtë aspekt, madje kam foto dhe informata edhe prej fshatit prej nga vie kolegu z.Haki Rudari, fshat ky i cili ka dal edhe postim në faqen e tyre, prandaj dua të di a është duke bankrotuar ajo Kompani, a ka probleme financiare, a ka mungesë të makinerisë, mungesë të punëtorëve apo çka ka.

2-A e kontrollon ndokush shefin e Zjarrfikësve, them këtë sepse shembull, qysh guxon ai person që orët e festës, nëse punohet 12 orë në punë, ne e dim çka thotë Ligji i punës ku edhe pa shkuar në punë fare i'u takojnë mëditjet, plus mëditja që i takon për punë gjatë festave mëditja dyfishohet, prandaj pyetja është përse nuk jua paguan ai orët shtesë Zjarrfikësve të cilçët edhe ashtu kanë mbete pak dhe që e kanë njëç punë goxha të zorshme, dimrit nga vërshimet, verës nga zjarret.

Pra unë kisha këto dy pyetje dhe nëse ka mundësi të marrë përgjigje.

z.Valdet Restelica, theksoi, kam një kërkesë në formë të pyetjes për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, tek çështja e Gjimnazit "Aleksandër Xhuvani" i nderuar drejtor kam marrë vërjetje bukur shumë prej prindërve dhe nxënësve që sidomos në periudhën e dimrit, edhe pse tani është kohë e nxehtë dhe ndoshta nuk është kjo brengë, por që është ambienti shumë i ftohtë i shkollës, andaj për dimër a keni planifikuar diçka më herët që kjo të rregullohet sepse ka pasë raste ku i'u është dashur edhe nxënësve të marrin nxemje ose diçka. Pra kur bëhet fjalë për një shkollë elitare siç është

Gjimnazi “Aleksandër Xhuvani”, por besoj se duhet të këtë përkujdesje që të rregullohet infrastruktura, përndryshe do të mendoja që është irelevante nëse shkojmë në atë se kur është bërë ose diçka tjetër, por duhet të fillohet tani të ndërmerret një plan konkret në mënyrë që gjatë periudhës së dimrit të jetë e përfunduar.

E di që në disa shkolla, shembull në shkollën ku unë punoj, keni bërë një projekt me efikasitet i cili ka qenë projekt mjaft i mirë, andaj do të dëshiroja që edhe në Gjimnaz të ndërmerren diçka.

z.Enis Dervisholli, theksoi, kam pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit edhe pse nuk qenka këtu por besoj që i’ a përcjellin, fjala është për rr.”Behram Abdullahu”, trekëndëshi “Besëlidhja” në gjatësi 33 metra te Lagja e “Metehive” është një kërkesë që kjo rrugë është premtuar goxha moti, andaj do të ishte mirë të merrej si shembull që të kryhet kjo rrugë.

Po ashtu edhe te Ndërmarrja “Eko-Llapi” e cila i ka vendos disa trafika (kioske) do të ishte mirë të investohej pak në to sepse e kanë çoroditur edhe qytetin pak si shumë, shumë keq po duken ato, pavarësisht që qyteti duket të jetë shumë mirë, andaj do të ishte mirë të merreni paska me ato kioske, t’i vëhet një fasad të paktën ose të ndërrohen krejt sepse nuk kushtojnë shtrenjtë ato.

z.Ermal Osmani, theksoi, deshta të ndërlihem dhe ta ngrisë një çështje e cila nuk është në kompetencë të Komunës, Kryetari i Komunës nuk qenka prezent këtu por është Nënkryetari.

E di që rruga Podujevë - Prishtinë është rrugë regjionale dhe hynë në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës, por duke parë që rreth 70% e Llapjanëve udhëtojnë për çdo ditë andej dhe po kanë vështirësi në një segment sa kanë mbete rreth 200 metra asfalt, andaj do të kërkoja edhe prej nënkryetarit të Komunës meqë është këtu prezent ose edhe Kryetarit të Komunës të bisedojnë me Ministrin e Asaj Ministrie pasi që janë edhe të të njëjtit subjekt politik sa i përket asaj pengese sepse po ndodh për çdo ditë që për 40 minuta deri në 1 orë të kalohet andej, pra të kërkohej të ndërmerren masa dhe të lirohet ajo rrugë sepse epo shkakton kolona të gjata, vonesa në punë për qytetarët e Komunës së Podujevës.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, i nderuar Kryesues ne jemi duke e zhvilluar këtë seancë sikurse gjithçka është normale kurse unë mendoj dhe konsideroj se ka gjëra jo normale këtu, në këtë seancë, andaj do të kërkoja së pari nga ti Kryesues që ta moderoni ashtu siç duhet seancën e Kuvendit sepse këtu nuk është një arenë ku njerëzit vijnë dhe sqarojnë hesape personale. Gjithashtu kam këshillë edhe prej të tjerëve që në qoftë se kanë diçka personale t’i sqarojnë ato jashtë kësaj seance, e në të njëjtën kohë nuk është faji i familjarëve tanë pse ne kemi vendosë të merremi me politikë, në qoftë se ndokush ka diçka personale me dikë të mos i përfshijnë familjarët sepse nuk është e ndershme.

Nuk po di çka të them më shumë, nuk kam fjalë më shumë, por mendoj se ndoshta do të ishte mirë të ndërpritet sot kjo seancë, të vazhdohet herëve tjera.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, po ndërlihem me fjalën e fundit të asambleistit, vërtetë ne duhet ta respektojmë dinjitetin dhe autoritetin e secilit, edhe të këshilltarëve të Kuvendit, edhe të drejtorëve të Drejtorive, andaj do t’ju lusja të mos vie puna të përsërisë dhe t’ia ndali fjalën ndokujt, mbi të gjitha jemi në dijeni për Rregulloren e punës së Kuvendit që nuk na lejohet që askush të përdorë shprehje ofenduese, nënçmuese e as paraqitje të të dhënave familjare, pra kjo është e rregulluar me Rregulloren të shkruar, andaj të mos na vije puna sepse ne jemi kolegë, jetojmë në mesin tonë të përbashkët dhe të gjithë jetojmë këtu dhe shihemi për çdo ditë në qytet, prandaj të bazohemi dhe të mbështetemi vetëm në diskutimet që janë të obliguara t’iu përmbahemi për çështje të cilat janë në rend të ditës.

Edhe njëherë ju lusë të mos vie puna të përsëritet më një gjë e tillë sepse pastaj edhe e ndërpres mbledhjen e që tani pothuajse jemi në përfundim të kësaj mbledhje ku klane mbete vetëm edhe

drejtorët Ekzekutiv të marrin fjalën për sqarime dhe përgjigje, besoj për 10 minuta t'i përfundojnë ato përgjigje nëse duan, ose të lehet në mbledhjen e radhës, nuk prish punë diçka por ju vendosni. **z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, unë do ta përfundoja këtë mbledhje, drejtorët e Drejtorive kanë mundësi të përgjigjen edhe në mënyrë elektronike, nëse nuk përgjigjen në sërish në seancën tjetër të radhës jemi këtu.

Sa i përket këtyre çështjeve familjare, është çështje e cila ka nisë pak më herët e që ndoshta atëherë është dashtë paksa të ndalet sepse pastaj çdokush e ka atë fjalën e vet, kështu që mendoj se nuk është nisë prej anës tonë por është nisë më herët dhe atëherë është dashtë të ndërpritet, mirëpo është ndoshta paksa keq sepse drejtorët e Drejtorive kanë më shumë autoritet këtu sesa anëtarët e Kuvendit edhe pse këtu është salla e anëtarëve të Kuvendit.

Keq u nisë muhabeti dhe nuk ka nevojë të vazhdoj por do të ishte mirë të ndërpritet kjo seancë, kurse përgjigjet mund të na jepen në formë të shkruar.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, mbetet që drejtorët e Drejtorive t'i japin përgjigjet dhe sqarimet e kërkuara në mbledhjen e radhës ose t'i dërgojnë me shkrim përmes e-maileve.

Atëherë e konstatoj të mbyllur / përfunduar këtë seancë.

Pas kësaj, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të mbyllur / përfunduar këtë mbledhje me rekomandim që për pyetjet e paraqitura nga ana e anëtarëve/eve të Kuvendit në këtë pikë të rendit të ditës (Të Ndryshme), përgjigjet apo sqarimet e nevojshme nga ana e Ekzekutivit të Komunës mund t'iu kthehen në mënyrë elektronike përmes e-maileve apo drejtpërdrejt në mbledhjen e radhës në pikën Të Ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën 14:20

Procesverbalin e mbajtën dhe hartuan;

Enis Sheholli

Arbrim Idrizi

Nr.Prot.01-060/04-0024294/26

Podujevë,

23 prill 2026

Kryesuesi i Kuvendit

Isak Shabani